**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

---

**01 Nr. 05/19**
**Rahovec, 23.05.2019**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **31 Maj 2019 ( Premte )** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.
Për këtë mbledhje propozoj këtë:

# R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave dhe KAB-it 2020-2022,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dalje në debat publik të Draft Rregullores Komunale për Transparencë,
5. Shqyrtimi i Informatës mbi Raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Afrim Dina**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 1820 Më / Dt. 31.05.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të neneve 12, 17, 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neni 2, neni 10 paragrafi 1 dhe 2, neni 39, 40, 57 dhe 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2019, merr këtë:

# VENDIM

## Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022

1. **Miratohet** vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022.

2. Shtojcë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2020-2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***U dërgohet:***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr. 1820**
**Rahovec, 31.05.2019**

**Afrim Dina**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Kuvendi i Komunës Rahovec**
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 1819 Më / Dt. 31.05.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

# RREGULLORE NR. 03/2019

# RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

**Rahovec, Maj 2019**

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L–040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë _________ miraton këtë:

# RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

## 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Më këtë Rregullore synohet që të arrihet:

1. Forcimi i transparencës në punë të organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.
2. Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Kjo Rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

### Neni 3
### Përkufizimet

Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

1. **"Mbledhjet e Kuvendit të Komunës"** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të këshilltarëve të Kuvendit;
2. **"Komitetet"** - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësive të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;
3. **"Pjesëmarrja e publikut"** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje;
4. **"Njoftimi i publikut"** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetat e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të

organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;

5. **"Tubime publike"** - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës – drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;
6. **"Peticioni"** - nënkupton kërkesën kolektive me shkrim që i adresohet Komunës, respektivisht Kryetarit të Komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës;
7. **"Konsultim publik i akteve komunale"** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;
8. **"Qasja në dokumentet zyrtare"**- nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare..

## Neni 4
## Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente brenda dites.
3. Njoftimi publik bëhet përmes:
   - mediave të shkruara dhe elektronike dhe
   - ueb-faqes së Komunës.
4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (i) datën e mbajtjes së mbledhjes, (ii) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (iii) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (iv) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
6. Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të bëhen publike tetë (8) ditë pas konfirmimit te ligjshmerise se tij.
7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.
8. Transmetimi në ueb-faqe të Komunës i seancave të Kuvendit të Komunës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna.

## Neni 5
## Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera

1. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e

merr kryesuesi i mbledhjes.

a. Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 7 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

b. Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

**Neni 6**
**Peticioni**

1. Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
2. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
   - rregullimin e qytetit,
   - mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
   - urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
   - mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
   - zbatimin e vetëkontrollit dhe
   - çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.
3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.
4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
5. Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjnë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.
6. Nëse një fshat, vendbanim apo lagje, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 10% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.
7. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

8. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejmë komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.
9. Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.

## Neni 7
## Takimet me publikun

1. Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarë së paku 2 (dy) herë në vit.
2. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
3. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
4. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
5. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
6. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
7. Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
8. Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.
9. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë 4 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me publikun.
10. Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.
11. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
12. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.
13. Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

14. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

**Neni 8**
**Konsultimi publik i akteve komunale**

1. Rregulloret dhe dokumentet me interes te pergjithshem te Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:
   a. shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
   b. mediave të shkruar dhe
   c. faqes së Komunës në internet.
3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.
4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.
5. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.
6. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

**Neni 9**
**Caktimi i zyrtarit përgjegjës**

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njesia/zyrtari për komunikim me publikun.

**Neni 10**
**Parimet e konsultimit publik**

Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:
1. **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;
2. **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare;

3. **Barazisë dhe mosdiskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në procesin e konsultimit publik;
4. **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt - propozimeve.

**Neni 11**
**Dokumentet për konsultim publik**

Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

1. Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës / ekzekutivit;
2. Projekt-buxhetin e Komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;
3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;
4 Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuader të fushave sektoriale;
5 Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;
6 Te gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.
7 Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

**Neni 12**
**Format dhe teknikat e konsultimit publik**

Publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si vegëza në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**Neni 13**
**Planifikimi i konsultimeve publike**

Planinfikimi i përgjithshëm konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

**Neni 14**
**Zbatimi i standardeve të konsultimit publik**

1. Komuna bën publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror.
2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.
3. Komuna për politikat e caktuara të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të siguroj konsultimin në fazat e hershme të hartimit, palët e interesuara që ndikohen apo janë të

interesuara të ndikojnë drejtëperdrejtë në procesin e vendimmarrjes.

4. Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

**Neni 15**
**Aktet nënligjore të Komunës për konsultim publik**

1. Aktet e Komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
   **1.1** Draft-Statuti i Komunës;
   **1.2** Projekt-Rregulloret Komunale;
   **1.3** Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale;

**Neni 16**
**Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik**

1. Kryetari i Komunës siguron që projekt-propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i permbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
2. Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin e projekt-propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve të percaktuara në këtë udhëzim administrativ.

**Neni 17**
**Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi**

Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mire / Zyra e Kryeministrit dhe për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal per konsultim publik.

**Neni 18**
**Transparenca e vendimeve të organeve të Komunës**

1. Publikimi në faqen zyrtare të Komunës i akteve normative të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm në afat prej 7 ditë pune nga konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit.
2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të Komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të Komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të Komunës.

**Neni 19**
**Transparenca financiare**

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të Komunës.
2. Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial.
4. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
5. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial.
6. Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

**Neni 20**
**Transparenca në aktivitetet e prokurimit**

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

**Neni 21**
**Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike**

Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si:

**1.1** Planin e punës së Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.
**1.2** Planin për Konsultim Publik.
**1.3** Planin për Komunikim Publik.
**1.4** Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara.
**1.5** Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane.
**1.6** Raportin vjetor të punës së Kryetarit dhe Kuvendit.
**1.7** Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve obligative.
**1.8** Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.
**1.9** Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e e-mail-it të drejtuesve të njësive brenda institucionit.
**1.10** Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:
**1.10.1** Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre.
**1.10.2** Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar.

**Neni 22**
**Hartimi i Planeve Vjetore të Punës në Komuna**

1. Komunat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.

2. Në përputhje me pikën 1 të këtij Neni Komunat obligohen të hartojnë Planin për Komunikim me Publik dhe Planin për Konsultim me Publikun.

**Neni 23**
**Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje**

1. Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:
   **1.1.** Planifikimi;
   **1.2.** Diskutimi;
   **1.3.** Marrja e vendimit;
   **1.4.** Implementimi dhe
   **1.5.** Monitorimi.
2. Mekanizmat e lartpërmendura duhet të shfrytëzohen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si:
   **2.1.** Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes së cilëve qytetarët do të mund të shprehnin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre;
   **2.2.** Përfshirjen e qytetarëve në grupet punues;
   **2.3.** Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje;
   **2.4.** Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin;
   **2.5.** Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të Komunës dhe shoqërisë civile.
3. Duke promovuar qeverisje të mirë, komunat inkurajojnë personat me nevoja të veçanta të moshuarit, minoritetet, të rinjtë, gratë në procesin e vendimmarrjes duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

**Neni 24**
**Plani i veprimit për transparencë në Komuna**

1. Komunat obligohen të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në kuvendin e komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.
2. Plani i veprimit për transparencë në komuna ka për synim t'i ofrojë publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.
3. Plani duhet të përfshijë:
   **3.1** Mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
   **3.2** Mbledhjet e Komiteteve;
   **3.3** Takimet publike;
   **3.4** Takimet konsultative;
   **3.5** Takimet obligative në media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të komunës;
   **3.6** Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të komunës;
   **3.7** Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi;
   **3.8** Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët;

3.9 Procedurat transparente të Prokurimit;
3.10 Procedurat transparente të punësimit;
3.11 Publikimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare;
3.12 Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimmarrje.

**Neni 25**
**Gjuhët për komunikim zyrtar**

1. Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
2. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës, jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i drejtohet Komunës.
4. Rregulloret komunale dhe vendimet mund të shtypen edhe në gjuhën e një komuniteti tjetër, nëse ai komunitet e kërkon atë.
5. Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
6. Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet e organizatat tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Gjuha turke dhe gjuha boshnjake mund të përdoren në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
7. Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore për gjuhët.

**Neni 26**
**E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës**

1. Cilido person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Rahovecit.
2. Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuara nga këto organe, për të gjitha fushat dha aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
3. Personat fizikë dhe ata juridikë, nga paragrafi 2 i këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikat, vendimet dhe punën e organeve të Administratës komunale.

**Neni 27**
**Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare**

1. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë

dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.

2. Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur më informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.
3. Organet kompetente komunale e kanë për obligim që, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesë, t'i kthejnë përgjigje me shkrim parashtruesit të kërkesës. Nëse kërkesa refuzohet, pala e pakënaqur me përgjigjen ka të drejtë ankese. Ankesa i dorëzohet Komisionit të ankesave, i cili duhet ta miratojë ose ta refuzojë ankesën në afat prej 15 ditësh.
4. Nëse organet komunale nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuse refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit).

## 2. DISPOZITAT KALIMTARE

### Neni 28
### Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përgjegjës është Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

### Neni 29
### Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Transparencë 01 Nr. 907 e datës 30.03.2016
2. Çdo dispozit e kësaj Rregullore që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përparësi do të kenë dispozitat e ligjit në fuqi.
3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr. 1819**
**Datë: 31.05.2019**

**Afrim Dina**
**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot / Br. prot. 1818 Më / Dt. 21.05.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

# PROCESVERBALI

-III-

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.04.2019** me fillim në ora **10.15.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i komunës z. Fatmir Iska, nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Selajdin Mullabazi", drejtor të drejtorive komunale, të nderuar kuvendar, pjesëtar të KFOR-it, OSBE-së, gazetar dhe media. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2019,**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimi të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale,**
5. **Shqyrtimi dhe aprvovimi i Vendimit të Kryetarit për miratimin e marrëveshjes për bashkëfinancim dhe themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të shtëpive për banim,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi",**
7. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec,**
8. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2019 – 2023,**
9. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve në komitet,**
10. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë,**
11. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 në vendin e quajtur Rakita – Xërxë, kompanisë "NTP Vëllezërit Morina",**

12. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma" Rahovec,**
13. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 591 të datës 16.02.2018, për Themelimin e Komitetit për Komunitete,**
14. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019".**

**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë a pajtoheni me këtë rend dite.
**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek pika e tretë e rendit të ditës Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2019, të nderuar nuk duhet të shkruhet shqyrtimi dhe aprovimi por vetëm shqyrtimi sepse raporti financiar nuk miratohet asnjëherë.
**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar rendi i ditës për mbledhjen e sodit është goxha i madh, për të qenë ne përmbajtjesor dhe të i shtjerrim temat ne besoj se brenda ditës së sodit nuk do të mundemi. është mirë që herrave tjera rendi i ditës të jetë më i pakët në mënyrë që ne të japim tamam kontributin se për çka kemi ardhur ne këtu. Nëse ne kemi temat të cilat nuk munden të tejkalohen, atëherë më mirë është të kemi dy mbledhje brenda muajit, edhe nëse dikush thotë se duhet të paguhemi për dy mbledhje unë propozoj që mos të paguhemi, por nuk është mirë të ngarkohemi në këtë shkallë sepse nuk është ai efekt të cilin duhet të kemi ne si kuvendar.
**Kryesuesi** – Ju faleminderit për vërejtjet dhe diskutimin e bërë të nderuar kuvendarë, nëse nuk ka askush të shtoj edhe diçka atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:
**1.Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
**Kryesuesi** – A ka dikush të jepe ndonjë vërejte apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse jo atëherë unë kam një vërejtje tek diskutimi imë tek pjesa e parë e lusë sekretarin e kuvendit që ta përmirësojë një gabim teknik që është bërë. E qes në votim pikën e parë (1) të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e 2 të rendit të ditës.
**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**
**Kryesuesi** - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin, fjala është e juaja të nderuar kuvendar nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.
**Fahrije Lushi Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, do të ndërlidhem me një pyetje e cila është bërë temë në nivel vendi e cila ka të bëjë me Drejtorin për punë Inspektuese. Të nderuar a keni dalë ndonjë herë të inspektoni ndonjë ndërmarrje pune e cila i ka deri në 10 punëtor, a keni inspektuar se si është siguria në punë e këtyre punëtorëve, a kanë këta punëtor kontrata, kjo temë është bërë mjaftë e ndjeshme dhe përmendet gati çdo ditë.
**Afërdita Thaqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e ngris një shqetësim, javën e kaluar me datë 25.04.2019 ditë e enjte shefi i kabinetit të kryetarit ka pasur përleshje fizike në objektin e komunës me një shërbyes civil, konkretisht me z. Enis Mullaavda. Të nderuar shefi i kabinetet të kryetarit është duke bërë presion të vazhdueshëm ndaj shërbyesve civil, pyetje ime konkrete për kryetarin është: Çfarë masa keni mare ndaj shefit të kabinetit, dhuna fizike është e ndaluar në rrugë e mos të flasim për institucione. A duhet që personat e kabinetit të kryetarit të gëzojnë imunitet, saqë që mos të japin llogari edhe para ligjit, kur e dimë se para ligjit jemi të barabartë të gjithë. Shqetësimi tjetër është punësime pa kritere, në një vend pune është kërkuar që ë ketë të kryer juridikun, kurse ju e keni punësuar një persona që e ka të kryer fakultetin e shkencave politike, shqetësimi imë është se Fakulteti i juridikut nga ai i shkencave politike dallon mjaftë, mundemi të marrim shembull edhe këtë fakt, sepse objektet e degëve të shkencave politike dhe të juridikut

12. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma" Rahovec,**
13. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 591 të datës 16.02.2018, për Themelimin e Komitetit për Komunitete,**
14. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019".**

**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë a pajtoheni me këtë rend dite.
**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek pika e tretë e rendit të ditës Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2019, të nderuar nuk duhet të shkruhet shqyrtimi dhe aprovimi por vetëm shqyrtimi sepse raporti financiar nuk miratohet asnjëherë.
**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar rendi i ditës për mbledhjen e sodit është goxha i madh, për të qenë ne përmbajtjesor dhe të i shtjerrim temat ne besoj se brenda ditës së sodit nuk do të mundemi. është mirë që herrave tjera rendi i ditës të jetë më i pakët në mënyrë që ne të japim tamam kontributin se për çka kemi ardhur ne këtu. Nëse ne kemi temat të cilat nuk munden të tejkalohen, atëherë më mirë është të kemi dy mbledhje brenda muajit, edhe nëse dikush thotë se duhet të paguhemi për dy mbledhje unë propozoj që mos të paguhemi, por nuk është mirë të ngarkohemi në këtë shkallë sepse nuk është ai efekt të cilin duhet të kemi ne si kuvendar.
**Kryesuesi** – Ju faleminderit për vërejtjet dhe diskutimin e bërë të nderuar kuvendarë, nëse nuk ka askush të shtoj edhe diçka atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:
**1.Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
**Kryesuesi** – A ka dikush të jepe ndonjë vërejte apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse jo atëherë unë kam një vërejtje tek diskutimi imë tek pjesa e parë e lusë sekretarin e kuvendit që ta përmirësojë një gabim teknik që është bërë. E qes në votim pikën e parë (1) të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e 2 të rendit të ditës.
**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**
**Kryesuesi** - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin, fjala është e juaja të nderuar kuvendar nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.
**Fahrije Lushi Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, do të ndërlidhem me një pyetje e cila është bërë temë në nivel vendi e cila ka të bëjë me Drejtorin për punë Inspektuese. Të nderuar a keni dalë ndonjë herë të inspektoni ndonjë ndërmarrje pune e cila i ka deri në 10 punëtor, a keni inspektuar se si është siguria në punë e këtyre punëtorëve, a kanë këta punëtor kontrata, kjo temë është bërë mjaftë e ndjeshme dhe përmendet gati çdo ditë.
**Afërdita Thaqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e ngris një shqetësim, javën e kaluar me datë 25.04.2019 ditë e enjte shefi i kabinetit të kryetarit ka pasur përleshje fizike në objektin e komunës me një shërbyes civil, konkretisht me z. Enis Mullaavda. Të nderuar shefi i kabinetet të kryetarit është duke bërë presion të vazhdueshëm ndaj shërbyesve civil, pyetje ime konkrete për kryetarin është: Çfarë masa keni mare ndaj shefit të kabinetit, dhuna fizike është e ndaluar në rrugë e mos të flasim për institucione. A duhet që personat e kabinetit të kryetarit të gëzojnë imunitet, saqë që mos të japin llogari edhe para ligjit, kur e dimë se para ligjit jemi të barabartë të gjithë. Shqetësimi tjetër është punësime pa kritere, në një vend pune është kërkuar që ë ketë të kryer juridikun, kurse ju e keni punësuar një persona që e ka të kryer fakultetin e shkencave politike, shqetësimi imë është se Fakulteti i juridikut nga ai i shkencave politike dallon mjaftë, mundemi të marrim shembull edhe këtë fakt, sepse objektet e degëve të shkencave politike dhe të juridikut

janë të ndara, njëri në fakultetin filozofik, kurse tjetri në fakultetin ekonomik, pra kjo dëshmon se nuk kanë asgjë të përafërt.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, në mbledhjen e kaluar unë e kam ngritur çështjen e objekteve kulturore dhe historike të komunës sonë, ku kamë kërkuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që për këtë mbledhje të na prezantojë një listë ku janë të vendosur objektet e komunës sonë që janë nën mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe historike. Arsyeja pse jam duke e kërkuar e kam sqaruar edhe në mbledhjen e kaluar, sepse në komunë tonë mendoj se ka ende objekte që nuk janë të regjistruar, dhe ne si kuvendarë mendoj se mundemi me dhënë kontribut që të gjitha objektet e kësaj rëndësie të futen në këtë listë. Konsideroj se ky është hapi i parë i mbrojtjes së tyre dhe pastaj të bëhet një strategji e përgjithshme se si do të bëhet mbrojtje dhe restaurimi i tyre. Prandaj nëse nuk e ka sjellë sot këtë listë drejtoreshe, e kisha lutur që në mbledhjen e ardhshme të na prezantoj këtë listë.

**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, sa i përket përgjigjes me shkrimë nga drejtori i shëndetësisë, i nderuar kjo nuk paraqet bazë, sepse dita simbolike kundër kancerit vetëm sa ka përfunduar, pavarësisht përpjekjeve tuaja që je munduar që ta paraqesësh një përgjigje por kjo nuk ka bazë. Kam edhe një pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë, kemi pasur raport të auditimit nga viti i kaluar ku kemi pasur rekomandime për participimin e blloqeve që paguhen nga ana e qytetarëve, ju keni qenë ai i cili e keni kritikuar shumë këtë raporte të auditimit, pyetje ime është: A keni mare masa në lidhje me këtë çështje, po ashtu unë edhe më parë kam kërkuar që së paku drejtoritë që janë më të rëndësishme të paraqesin raporte katër mujore të punës, në mënyrë që ne të i shohim vazhdimisht punë të cilët ju jeni të ngarkuar si ekzekutiv.

**Afrim Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në bisedë me disa banorë të fshatit Dobidol, ata më shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me bllokimin e një kanalizimi. Këta banorë ankohen sepse ujërat zaza dalin mbi sipërfaqen e tokës, ku në shumicën e rasteve shkon edhe në oborret e shtëpive të tyre, ku pastaj kundërmo një erë e keqe, sipas atyre rastin e kanë paraqitur tek KRU – Gjakova pothuajse qe një vit, por nde nuk kanë marë asnjë përgjigje për zgjidhjen e këtij problemi nga ana e tyre, madje ata i kanë thënë se kjo nuk është punë e jona. Po ashtu këta banorë thonë se kanë kontaktuar edhe me organet e qeverisë komunale në Rahovec, por problemi i tyre ende mbetet i pa zgjidhur, shpresojmë se ky problem i këtyre banorëve të zgjidhet sa më shpejtë që është e mundur. Pyetje e dytë ka të bëjë me segmentin rrugor Dejnë – Ratkoc, fëmijët e këtyre fshatrave udhëtojnë çdo ditë për në shkollë dhe jeta e tyre është e rrezikuar pasi që në këto fshatra nuk ka trotuare dhe as ndriçim. Mbesë me shpresë se këto dy kërkesat e mija shumë shpejtë të realizohen.

**Refki Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua ta ngre një shqetësim rreth ndërtimit të rreth rrotullimit në fshatin Xërxë i ku që një kohë të gjatë kanë ngecur punimet. Kërkesa jonë është që komuna të ndikojë që sa më shpejtë ky rreth rrotullim të përfundoj sepse rrezikshmëria është shumë e madhe, për arsye se ky rreth rrotullim që gjendet tek shkolla fillore në fshatin Xërxë.

**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ju faleminderit për kontributin që e dhatë duke e ngritur shqetësimet e juaja, disa pyetje do i përgjigjem unë, disa do i përgjigjen drejtorët e drejtorive përkatëse. I nderuari z. Fehmi Cena ju siguroj që në seancën e radhës do ta keni të gatshme këtë listë, lista është por pajtohem me ate që e tha edhe z. Dervish Çadraku se për këtë seancë ka mjaftë pika. I nderuari z. Dervish Çadraku, me të vërtet ka pika shumë dhe kjo mbledhje është e ngarkuar, nëse jeni ju dakord munden të mbahen edhe dy mbledhje , por duhet të dini se njëra paguhet kurse tjetra nuk paguhet. Përndryshe me të vërtet volumi është i madh dhe 14 -15 pika brenda ditës nuk është lehtë me i kapërcyer siç i ka hije, por siç e thash ne mundemi të e ndajmë këtë mbledhje në dy pjesë, gjithmonë nëse jeni edhe ju të pajtimit. E nderuar znj. Fahrije Lushi, inspektorati i Komunës së Rahovecit inspekton ndërmarrjet private, ne kemi inspektorin e punës, por ka edhe inspektorë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ne e dimë se të gjitha e kanë një qëllim të përbashkët që punëtorët të trajtohen sipas ligjit të punës, pra të dihet orari i punës, pagesa, pastaj deklarimi i tyre në administratën tatimore të Kosovës etj. në emër tuajin e nderuara Lushi, si dhe në emrin time dhe të gjithë qytetarëve e ftoj inspektorin e punës dhe gjithë

inspektoratin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të punojnë sa më shumë që ta vendosin një standard më të mirë të mirëqenies, të drejtave, detyrimeve dhe detyrave që kanë reciprokisht, pronarët e kompanive private, pra të respektohet ligji. E nderuara znj. Afërdita Thaqi e ngriti një shqetësim goxha interesant, ne jemi një vend i vogël dhe e vërteta është krejt ndryshe nga ajo që r tha e nderuara. E nderuar së pari konflikt fizik nuk ka pasur, përplasjet verbale ndodhin, është në përgjegjësin e kryetarit të komunës nëse stafi i tije mundet të involvohet në një mënyrë ose në tjetrën. Po ashtu edhe për shërbyesit civil ka procedura tjerë , ka komisione disiplinore etj. Mendoj se kjo aspak nuk është temë e kuvendit sepse ka mjaftë resurse që do të merren me këto që i tha znj. Afërdita nëse kanë ndodhur, ju siç e dini ne i kemi kamerat e sigurisë dhe gjithçka është e qartë, dhe kur do që e vlerëson kryetari i komunës se ka nevojë i merë incizimet, dhe pastaj si për të mirë ashtu edhe për të keqe përgjegjësia i takon kryetari të komunës, sidomos për staf politik. Sa i takon punësimeve, po ashtu edhe këto janë publike, ka një protokoll, ka rregulla të lojës dhe në rast të pakënaqësisë ka procedurë të ankimimit, nëse ka ankesë ka po ashtu edhe organet që i shqyrtojnë ankesat. Nuk e besoj se ka shkelje se po të kishte shkelje po ju sigurojë se konkursi kishte me u anulu nga komisioni i pavarur i ankesave. I nderuar z. Afrim Berisha ne jemi ne diskutime publike me të gjitha lokalitet tona, kemi qenë edhe në fshatin Dobidol, shqetësimi i tyre për ujërat e zeza është me vend sepse është bllokuar kanalizimi. Po ashtu ka pjesë ku nuk ka fare qasje në kanalizime, përgjegjësitë janë nga njëherë të ndara nganjëherë të përbashkëta, nëse familjet tona paguajnë në faturën e ujit të pijes edhe pagesën edhe për mirëmbajtjen e ujërave të zeza, kjo i bie që KRU- Gjakova është përgjegjëse që ti zhbllokoj situata të tilla, por aty ku nuk ka kanalizim është detyrë e komunës që të bëjë. Me kontratën që tani e kemi lidhur e di që është e paraparë edhe ndërtimi i kanalizimit në Dobidol. Sa i përket trotuareve, ne kemi kontratë për rregullimin e trotuareve, dhe natyrisht janë pikat më kritike të cilët mendojmë se duhet të ndërhyjmë. Në kontratën aktuale që e kemi do të shohë a është i paraparë ai segment të cilin ju jeni duke e kërkuar, nëse jo ne do të hapim përsëri kontrata për rregullimin e trotuareve sepse kërkesa ka mjaftë. I nderuar z. Refki Kryeziu sa rreth rrotullimi dhe nënkalimi është kontratë që Ministria e Infrastrukturës e ka lidhë qe tre vite, në rastin e Xërxës ka pasur probleme me pronën e hekurudhës, besoni se me shumë vështirësi e kemi zhbllokuar. Ka pasur probleme me një lokal aty që është në mes dhe punë kryesi kërkon që një pjesë e atij lokali të lirohet, ai lokal nuk ka kontratë, unë e kam ngritë këtë shqetësim edhe më Ministrin e Infrastrukturës si për Xërxë ashtu edhe për Krushe të Madhe. Po ju përgjigjem edhe për Krushe sepse ai projekt nuk i ngjanë fare një rreth rreth rrotullimi, sepse dikujt ja merë të gjithë pronën dikujt shumë pak, prandaj ne kemi kërkuar ridejzanim të projektit. Ose do të ndërtojmë një rreth funksional ose fare nuk do të ndërtojmë, e jo të ndërtojmë një rreth ku do të kapën në mes vete njerëzit të përleshen. Besoj se do i japim zgjidhje për këto dy projekte këtë javë, ku do të vije një komision dhe nëse vije ne si komunë do të japim kontributin tonë që rreth rrotullimi në Xërxë dhe Krushë të Madhe të kryhen sa ma shpejtë që është e mundur dhe të jenë sa më funksional.

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar kuvendar z. Ali Zhuniqi me kërkesën të kryetarit të komunës është bërë auditimi i jashtëzakonshëm në Drejtorin e Shëndetësisë, ku auditimi ka konstatuar disa parregullsi që janë bërë në participim në fletë pagesa. Nga viti 2007 dëftesë pagesat nuk janë dorëzuar, ku punëtorët shëndetësor nuk janë barazuar me Drejtorin e Shëndetësisë, pas rekomandimeve të auditorit të brendshëm punëtorët shëndetësor janë barazuar me dëftesë pagesa.

**Afërdita Thaqi** – Faleminderit kryetar për përgjigje, por unë për vete nuk jam ë e shqetësuar sepse mua nuk më ka ndodhur por i ka ndodhur qytetarëve të mijë. E gjithë qëndron ashtu si kam thënë unë e jo ashtu si ju u përgjigjët. Kurse sa i përket kritereve për punësim edhe në mandatin e kaluar i ke punësuar njerëz me shkollë të mesme, ajo që më shqetëson është se ku do të mbesin e ardhmja jonë, duhet të llogarisni se keni fëmijë ju, kam motër dhe vëlla dhe shumë të tjerë. Mendoj se duhet të mundohemi për një edukim më të mirë se sa ashtu shkelë e shko si pas lufte ne edhe ashtu jemi në këtë gjendje.

**Kryetari** – E para punë asnjë qytetar nuk është i shqetësuar sepse ajo që e thua ti nuk qëndron ashtu, ne i kemi kamerat e sigurisë, unë çdo ditë gati i shikojë kamerat e sigurisë. Ju jeni të shqetësuar dhe shqetësimi i

juaj është me vend sepse asgjë nuk duhet të ndodhë në institucionet e komunës së Rahovecit, por mos u mërzit për qytetarët e komunës sepse asgjë nuk ka ndodhur që të shqetësohesh.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e radhës:

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2019.**

**Afrim Limani** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtori limani prezantoi para anëtarëve të kuvendit Raportin financiar 3 mujorë, ku potencoi se në këtë raport janë të përfshirë të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare të cilat janë realizuar brenda këtij afati 3 mujorë. Për arsye të vonshëm të miratimit të buxhetit në nivel vendi dhe alokim të vonshëm të buxhetit, ne si drejtori komunale nuk kemi mundur të i procesojmë të gjitha pagesat në të gjitha kategoritë, dhe për këtë arsye raporti i shpenzimit figuron më i vogël në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu drejtori limani e lexoi raportin 3 mujorë faqe për faqe anëtarëve të kuvendit. Të hyrat e rregullta janë realizuar 246,957.00 €, krahasim me vitin e kaluar kemi një ndryshim negativ në vlerën prej 4,367.00 €. Gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut kanë pasur një realizim të mirë prej 284,136.00 €, krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje prej 8,991.00 €. Kurse sa i përket të hyrave të tatimit në pronë, brenda këtyre tre muajve kemi pasur të hyra 104,804.00 €, nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të viti të kaluar kemi një rrënje prej 9,043.00 €. Kurse buxheti i shpenzuar në total është 2,783,000.00 €, ku në përqindje i bie 20.23%.

**Masar Popaj** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të flasë sa i përket krahasimit të hyrave sipas kodeve ekonomike 2018/2019, kodi i tatimit në pronë dhe tatimi në toka, realizimi në vitin 2018 ka qenë 112,474.80 €, kurse në vitin 2019 është 103,431.27 €, ka pasur një rrënje prej 9,043.53 €. Pastaj tek taksa rrugore në vitin 2018 kemi pasur të hyra prej 19,700.00 €, kurse në vitin 2019 kemi pasur 19,240.00 €, edhe këtu kemi një rrënje prej 460.00 €. Pastaj tek kodi taksat e tjerra administrative në vitin 2018 kemi pasur të hyra 29,457.43 €, kurse në vitin 2019 kemi të hyra 14,819.50 €, edhe këtu kemi një rrënje prej 14,637.00 €. Pastaj kodi gjobat në trafik ë vitin 2018 është 17,425.00 €, kurse në vitin 2019 është 33,966.00 €, këtu kemi një ngritje prej 16,541.00 €. Pastaj taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vitin 2018 kemi pasur të hyra prej 20,861.00 €, kurse në vitin 2019 kemi pasur të hyra prej 17,467.00 €, këtu kemi një rrënje prej 3,394.00 €. Kisha kërkuar nga drejtori limani të na tregoj pse ka rrënje të të hyrave në disa kode.

**Ali Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, sa i përket të hyrave mendoj se janë të kënaqshme për këtë tre mujorë, nëse i shikojmë se të hyrat e rregullta nga gjobat në trafik dhe nga gjykatat kemi pasur një rritje. Tek kodi i krahasimit të të hyrave sipas kodeve ekonomike, tek tatimi në pronë dhe tokë e ceku edhe kolegu z. Masar Popaj ka një rrënje, besoj se drejtori do e japë përgjigjen, por unë mendoj se kjo ka ndodhur për arsye se ende nuk ka filluar aplikimi për subvencione, sepse siç e dimë në këtë periudhë më së shumti bëhet pagesa e tatimit në pronë, por besoj se kjo do të përmirësohet kur të filloj subvencionet. Tek taksa komunale për leje ndërtimi të planifikuara janë 35,000.00 €, realizim në vitin 2018 është 13.00 €, kurse në vitin 2019 realizimi është 11.00 €, mos është bërë ndonjë gabim apo si qëndron puna. Janë edhe disa shifra të paqarta edhe nëpër disa kode tjera, besoj se kolegët e tjerë do i paraqesin, të gjitha që i pata unë për të ngritur i ngrita.

**Vahid Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek kodi i shpenzimeve tek zyra e kryetarit të komunës kemi 2,800.00 € në krahasim me vitin 2018, bëhet fjalë tek shpenzimet për anëtarësim, realisht nuk jam duke kuptuar këtë shpenzim, besoj se do më japim përgjigje. Tek administrata kemi një shpenzim prej 5,975.00 € tek shërbimet kontraktuese tjera, për këtë mendoj se është dashur të kemi një raport të veçantë, por besoj se drejtoresha do na jepe përgjigjen se cilat janë këto shpenzime. Tek inspektorati e kemi një shpenzim prej 231.00 € për karburante për vetura, që i bije diku për 3 muaj të i bëjnë çdo ditë, nga 50 km, a ka ndonjë raporte se çka kanë bërë këta inspektorë për këto 3 muaj.

**Fehmi Cena** – Mendoj se ky raporte është mirë i dizajnuar dhe është shumë i qartë dhe gjithëpërfshirës, ku i ka të gjitha kategoritë buxhetore dhe krahasimet me vitin e kaluar, dhe me këtë ne kuvendarët i kemi shumë të qarta gjërat në këtë raport. Të nderuar në raport me planifikimin kemi rritje, por nëse e krahasojmë me vitin 2018 kemi rrënje, tek gjobat kemi rritje, sidomos ato të trafikut, por ne e vlerësojmë komunën sipas të hyrave vetanake pa gjoba e trafikut dhe gjykatave. Ne si komunë kemi planifikuar për këtë vit kemi tatimin

në tokë, prandaj ne kemi pritur që këtë vit të kemi më shumë të hyra, në përgjithësi në të gjitha kodet ka rrënje por unë do të ndalem pak tek participimi në shëndetësi. Planifikimi ka qenë 50,000.00 €, kurse realizimi është vetëm 16.58 %, kurse është dashur të jetë ¼ sepse ne e kemi kaluar ¼ të vitit. Drejtoria duhet të gjejë formën për të i rritur të hyrat në participim, disa herë e kam cekur pse drejtoria për shëndetësi nuk po e formon komisionin mjekësor për dhënien e certifikatave për patentë shofer, kjo ka dobi të dy anshme edhe do i shërbejmë qytetarët tanë edhe do të krijojmë të hyra për komunën tonë. Tek shpenzimet sipas programeve në faqe nr.7si tek pagat dhe mëditjet dhe tjerat mendoj që është dashur edhe një shtyllë parapara ta qitni në raport, pra të ceket se sa ka qenë planifikimi për këto kategori, dhe pas kësaj ne kishim me pas mundësi të dimë se sa janë shpenzuar dhe se a ka pasur punësime shtesë apo jo. Tek shpenzimet e mallrave dhe shpenzimeve sipas programeve jemi duke parë që shpenzimet kanë qenë në të gjitha dikasteret, më pak me vitin paraprak edhe pse mendoj se periudha tre mujore nuk është shumë realiste për të përcaktuar shpenzimet që janë bërë, por besoj se do ta kemi një situatë më realiste në raportin gjashtë mujorë.

**Dervish Çadraku** – Ajo që më bënë mua përshtypje në këtë raport është se ka një shpërputhje dhe për këtë kërkoj një sqarim nga drejtori, dua ta di a ka shpërputhje sepse nuk kanë qenë shumë aktiv për të plotësuar parashikimet e tyre apo nuk kanë ndodhur me dëshirën e tyre. Shumë shpesh gjërat edhe nuk ndodhin me dëshirën tonë. E marrim për shembull tatimin në pronë ku e shohim se kanë planifikuar 388,767.00 €, kurse janë realizuar vetëm 103,431.00 €, kjo është një diferencë shumë e madhe. Drejtorët mendoj se është dashur të i shikojnë edhe vitet e kaluara se si kanë qenë, dhe si kanë ardhur deri tek realizimi i këtyre objektivave, e jo të ja fusim kotë dhe të bëjmë me atë entuziazmin fillestar se ne do të bëjmë realizimin e parashikuar, kurse në fund e shohim se do të biem në rrafshin real, këta zëra i kemi çdo ku si në taksa komunale, pastaj në regjistrimin e trashëgimisë ko objektivi është shumë i lartë kurse realizimi është shumë i vogël. Tek taksat për certifikatën e lindjes janë parashikuar 45000, në 2018 janë realizuar 17.000, kurse në 2019 janë realizuar 13800, pastaj taksat për certifikatat e vdekjes 4500 parashikimi, në vitin 2018 janë realizuar 388, kurse në vitin 2019 janë realizuar 410, mendoj se parashikimet janë shumë të pa bazuar dhe mendoj se kjo është një dobësi e drejtorëve që nuk kanë mundur të i parashikojnë mirë. Sa i përket gjobave të gjykatave dhe të trafikut, mendoj se ne këtu nuk kemi çka të bisedojmë, unë shpesh herë e kam thënë se këto gjoba janë një lloj infuzioni për komunën, tani kemi një rritje gati prej 49%, kurse tek dënimet jemi në minus, ne nuk duhet të bazohemi tek gjobat e trafikut sepse ato nuk varen nga ne. Tek taksa për ushtrimin e veprimtarisë edhe pse nuk e di se çka është por janë paraparë 75,000.00 €, kurse janë realizuar vetëm 17,467.00 €, dhe shumë e shumë taksa tjera mos të i përmendi rend një nga një.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë raport financiar. Sa i përket këtij raporti nëse ndalemi tek të hyrat vetanake të realizuara në baza mujore karshi viti 2018, mundemi të themi se kemi një rrënje të vogël, por besoj se me angazhimin pak më të madh do të kishte një ngritje pak më e madhe. Kurse sa i përket gjobave në trafik e kam thënë edhe në KPF, se ne nuk duhet të i gëzohemi këtyre gjobave, sepse ati tregojnë një parregullsi në trafikun tonë. E nderuara znj. Florida Bajraktari në KPF i ka përmendur disa kode, ku ka propozuar që të i shtohen këtij raporti, por nuk jam duke i parë edhe tani mungojnë, mendoj se është dashur që të jenë sepse na është premtuar. Ajo që dua të ceki dhe që është më e rëndësishme sipas meje është se ne kemi shpenzime sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike, mendoj se tek shpenzimet kapitale është dashur të shpenzohet më shumë buxheti, sepse buxheti i planifikuar për shpenzime kapitale ka qenë 4,203,391.00 €, alokimi ka qenë 1,705,741.00 €,, kurse shpenzimet janë 756,396.00 €. Nëse vitin e ndajmë në katër periudhe nga tre muaj atëherë mendoj se është dashur të shpenzohet buxheti pak më tepër. Pastaj kemi rritje të shpenzimeve tek shërbimet publike, në vit 2018 kanë qenë 25,191.00 €, kurse në vitin 2019 janë 36,866.00 €, kaq e kish unë.

**Sali Sallteku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe pse pak mare vesh nga aspekti ekonomik, mendoj se z. Afrim Limani e ka bërë një unë të mirë, sepse e ka dhënë një pasqyrë të mirë dhe për vete e përkrahi për punën që e ka bërë deri më tani.

**Refki Kreziu** – E kam vetëm një pyetje, tek krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike 2018/2019, tek taksa e të hyrave nga pyjet nuk ka as të planifikuara e as të realizuara, sa e di unë të hyra nga pyje ka, si është e mundur të jetë zero.
**Afrim Limani** – Ju faleminderit për pyetje, po ja filloj me ju përgjigj z. Masar Popaj, i nderuar rrënja e tatimit në pronë është sepse nuk është aplikuar ende mos aplikimi i subvencioneve, në periudhën e aplikimit të subvencioneve kemi një rekord të të hyrave të tatimit në pronë, nuk dua ta fajësoj askënd por ky është një realitet. Pastaj ishte një pyetje tjetër pse ka rrënje në disa taksa tjera, i nderuar ne duhet të bëjmë një dallim të të hyrave që janë të ndikuese dhe pa ndikuese, pra janë disa të hyra të cilat ne mundemi të ndikojmë, po ashtu ka edhe disa të hyra që nuk varen nga ne. Por është e vërtet se të hyrat e komunës për këtë periudhë kanë qenë më të vogla në krahasim me vitin e kaluar, por shpresoj se në raportin 6 mujorë do të kemi një inkasim më të mirë. I nderuari z. Ali Morina taksë komunale për leje ndërtimi realisht nuk ka pasur, por në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit e kemi edhe një taksë për planin urbanistik dhe në këtë taks ne kemi një inkasim të mirë. I nderuar z. Vahid Krasniqi, kodi për shpenzimet për anëtarësim është për asociacionin e komunave të Kosovës, komuna jonë dhe komunat e tjerë kanë një marrëveshje ku e bëjnë pastaj pagesën e anëtarësimit dhe kjo anëtarësi është 5,000.00 € në vit. Pyetje tjetër ishte shpenzimet për karburant nga Drejtoria për Inspektorat, kjo ka ndodhur sepse si prioritet për pagesë i kemi dhënë shpenzimeve për karburant dhe për këtë arsye tani figuron si shpenzim më i madh. I nderuari z. Fehmi cena e çmojë atë që e thatë, por desha të shtoj edhe diçka rreth asaj që e tha edhe drejtori i shëndetësisë, për shkak të auditimit që është bërë në këtë drejtori, janë ndërmarrë disa veprime të mira dhe konsideroj se rezultatet janë vetëm ka shihen, vazhdimisht jam duke e monitoruar dhe jam duke parë procesin e inkasimit, pra kemi një nkasim të mirë të të hyrave. I nderuari z. Dervish Çadraku e ceku se ka një mos harmonizim në mes planit dhe realizimit, i nderuar Ministria e Financave për dy lloj të hyrave nuk na pyet neve fare, ajo e bënë vetë planin dhe ne duhet vetëm të zbatojmë, fjala është për tatimin në pronë, tokë dhe tatimin për mbeturina. Por mos hare që në fund të vitit të shikosh se sa ka dallim plani në raport me realizimi, por sipas analizave tona përafërsisht duhet të jetë e njëjtë. I nderuar z. Rasim Fazliu ju kërkoj falje që paskam harruar të i fus ato dy kode që i ka propozuar znj. Florida bajraktari, por ju premtoj se si të dal nga mbledhja do e përmirësoj raportin. Sa i përket shpenzimit të vogël për investime kapitale, kjo është për arsye të alokimit të vonshëm të buxhetit, nuk kemi pasur kohë dhe hapësirë më shumë. I nderuar z. Refki Kryeziu arsyeja pse nuk kemi të hyra nga taksa për pyje, ne së bashku me drejtorin e bujqësisë dhe me sektorin e bujqësisë jemi mare shumë me këtë problematik, ku kemi marrë një përgjigje se të hyrat nga pyjet janë duke u regjistruar tek një lloje takse për shërbime administrative, ne do të shkojmë një ditë që të vërtetojmë a është kjo e saktë apo jo, nëse po atëherë duhet të i lusim që ti derdhin në kodin adekuat.
**Kryesuesi** – Ju faleminderit të gjithëve për pyetje, po ashtu e falënderoj drejtorin e financave për sqarimet që ju dha. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:
**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimi të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.**
**Isak Hoti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar në mungesë të drejtorit të shërbimeve publike, do ju prezantoj unë këtë pikë. Është kërkuar plotësim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, tek neni 8.2 është kërkuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, që për ormanët që lajnë duke u vendosur nga KEDSI nëpër qytet, për futjen e rrjetit nëntokësor tarifa të ritet nga 150.00 € në 200.00 €. Kjo tarifë do të paguhet një herë në fillim e jo çdo vitë
**Fehmi Cena** – Këtu kemi të bëjmë me një rritje të taksës, tani z. Hoti na tregoi se për këtë taks do të bëhet një herë pagesa nga KEDSI, ne e kemi përkrah këtë rritje të taksës sepse do të kemi më shumë të hyra për komunën tonë. Ne e kemi pasur një vërejtje edhe në KPF, po ashtu edhe sot e kemi të njëjtën vërejtje, sepse vendosja e këtyre ormanëve nuk është duke u bërë në mënyrë të rregullt, dhe pastaj janë duke paraqitur pengesë në trotuare. Kisha kërkuar që komuna të jetë më e kujdesshme në këtë, jemi pro që të punohet por vendosja e tyre të jetë sa më e rregullt, përndryshe këtë ndryshim të tarifës mendoj se duhet ta mbështesim.

**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shumë keq që nuk qenka prezent sot drejtori i shërbimeve publike sepse ndryshimi i kësaj rregullore është shumë me rëndësi. I nderuari kryesues së pari mendoj se është dashur të kemi ne sot prezent rregulloren ekzistuese komplet në mënyrë që të dimë se ku është ndryshimi. Do ju shpjegoj se si ka qenë më herët që të keni më të qartë pastaj, pas kërkesave të shumta të KEDSIT gjatë mandatit të kaluar, ne disa herë e kemi diskutuar këtë çështje, edhe atëherë e kemi kërkuar që të bëhet ky ndryshim që të lehtësojmë investuesit të KEDSIT në mënyrë që të bëjnë investime në Komunën e Rahovecit. Gjithsesi se pajtohem me këtë por atëherë tarifat kanë qenë ndryshe kurse tani janë tarifat vjetore, por gjithsesi se 200.00 € për $m^2$ nuk është shtrenjtë, por këtu e keni specifikuar vetëm për KEDSIN, të nderuar nuk certifikohet një vendim i cili merret një anshëm dhe selektiv. Të nderuar kuvendarë propozoj që të specifikohet në vendim se kjo vlen për të gjithë shfrytëzuesit e MDF-së, me këtë do të kemi ankesa të tjera sepse kemi bërë selektime.
**Munib Durguti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe unë jam i mendimit që është dashur të kemi komplet rregulloren me një arsye shtesë, në mbledhjen e kaluar sa e di kolegu z. Rexhep Oruçi e ka ngritë shqetësimin rreth disa participimeve që janë bërë ndaj pensionisteve dhe personave me aftësi të kufizuar. Neve na është dhënë premtim publik se në mbledhjen e radhës do të keni komplet rregulloren me ndryshimet e kërkuara. Neve tani na ka ardhur një propozim për rritje të taksës për ormanët e KEDSIT, për të cilin nuk jam kundër, por neve nuk në është dhënë një përgjigje konkrete për fatin e listës së participimeve në shëndetësi.
**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë z. Fehmi Hoxha e ka dhënë një propozim që kjo taksë të jetë për të gjithë shfrytëzuesit e MDF-së.
**Isak Hoti** – Të nderuar ne edhe ashtu duhet që të ndryshojmë komplet rregulloren, kjo rregullore është problem nacional, jo vetëm problem i komunës sonë, për vetë faktin e ndryshimit të ligjit për kundërvajtje. Ministria e Financave është duke e diskutuar dhe sa jam i njoftuar është në fazën finale të hartimit të një Draft rregullore për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa, kjo taksë do të bëhet unike për të gjithë komunat, pastaj sipas specifikave të komunave do të futen edhe taksat. Kjo është bërë për arsye të KEDSIT për të i futur kabllot nëntokësore, ne realisht nuk kemi ndonjë kërkesë tjetër nga ndonjë operator tjetër, ne nuk e dimë a do të certifikohet, përgjigja do na vije pas dërgimit për ligjshmërinë e aktit në ministri. Propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike është që të jetë vetëm për KEDSIN, pastaj kur të vije ndryshimi i rregullores kompletë të ulemi dhe të diskutojmë, po ashtu pastaj mundemi të i fusim edhe këto propozime.
**Fehmi Hoxha** – Të nderuar po ju siguroj se kështu në mënyrë të një anshëm nuk do të certifikohet, me këtë po na dele që ne jemi duke prashitur vetëm në ujë. Është e vërtet se ajo që e tha z. Hoti do të bëhet ky unifikim, ku do të caktohet edhe përqindja për inkasim, po ashtu është e vërtet se edhe rregulloret e tjera të komunave tjera kanë problem të mëdha. Prandaj është mirë që për të gjithë ata operatorë që bëjnë kërkesë në Drejtorin e Shërbimeve Publike taksa të jetë me këtë ndryshim, e jo të jetë vetëm për KEDSIN.
**Fehmi Cena** – Kishte me qenë mirë që ne të i sqarojmë gjërat para se me e mare një vendim, këtu kemi të bëjmë me një tarifë, ne jemi dakord që të gjitha kompanitë të cilët e bëjnë punën e njëjtë të i nënshtrohen tarifës, por sa duhet të jetë kjo tarifë ne nuk duhet të vendosemi sot, ajo duhet të vije nga drejtoria. Jemi duke parë tani që mungesa e drejtorit është duke na bërë probleme ne në parim mundemi të marrim vendim që edhe ata të i nënshtrohen taksës, ose të e shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme.
**Fehmi Hoxha** – Të nderuar tarifën drejtori e ka caktuar ka qenë 150.00 € kurse propozimi është 200.00 €, por unë propozoj që të jetë për të gjithë, ne kemi pasur mjaftë probleme me mos inkasim si nga KEDSI dhe të tjerë për arsye të mos harmonizimit të rregullores, jam pro propozimit prej 200.00 € por për të gjithë.
**Isak Hoti** – Neve nuk na kushton asgjë nëse i vendosim edhe për operatorët e tjerë të jetë kjo taksë, por ne duhet të shikojmë se çfarë tarife kanë ata operator të tjerë, por ju jeni ata që vendosni e jo ne.
**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë z. Fehmi Hoxha e ka dhënë një propozim që kjo taksë të jetë për të gjithë shfrytëzuesit e MDF-së. E qes në votim propozimin e z. Fehmi Hoxha: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i z. Fehmi Hoxha. Kalojmë në pikën e radhës:

**5. Shqyrtimi dhe aprvovimi i Vendimit të Kryetarit për miratimin e marrëveshjes për bashkëfinancim dhe themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të shtëpive për banim.**

**Isak Hoti** – Është nënshkruar një marrëveshje me bashkëfinancim të cilën e ka hartuar zyra ligjore, kjo marrëveshje është nënshkruar në mes kryetarit të komunës dhe shoqatës Jetimët e Ballkanit, ku kanë shpreh dëshirën që shtatë shtëpi të ndërtohen në komunën e Rahovecit për skamnor. Komuna e Rahovecit do të participoj nga 5,000.00 € për secilën shtëpi, pos kësaj marrëveshje e keni edhe një vendim për anëtarët e komisionit që duhet sot të mirët nga ana juaj. Ky komision mundet të ketë 5 ose 7 anëtar për ate ju vendosni, ky komision do ti vlerësoj kërkesat të cilat vinë, pastaj në bazë të përzgjedhjes së këtyre kërkesave do të ndërtohen këto 7 shtëpi.

**Rasim Fazliu** – Është shumë mirë që qytetarëve në nevojë të komunës së Rahovecit i vije në ndihmë një njeri siç është z. Halil Kastrati gjithsesi në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit. Ne si grupe i PDK-së e mbështesim këtë marrëveshje, besoj se do e mbështesin të gjithë sepse ku të kemi edhe raste të tjera që ti dalin në ndihmë qytetarëve tanë të cilët janë në nevojë.

**Fehmi Cena** – disa vërejtje që i kemi pasur në KPF mendoj se tani këtu në këtë mbledhje u sqaruan, buxheti që është ndarë nga komuna është buxhet që ne vetë e kemi votuar në shumën prej 35,000.00 €. Mendoj se gjithçka është e qartë, do të jetë komisioni i cili do të bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe pastaj do të marrin një vendim se kush duhet të i gëzoj këto shtëpi, prandaj mendoj se ne duhet të përkrahim këtë marrëveshje. Komuna nuk është në mesin e atyre komunave që dallohet shumë që njerëzit aq shumë kanë nevojë për shtëpi, por sigurisht se edhe në komunën tonë mundet të gjendet dikush që ka nevojë të i ndërtohet shtëpia. Ne dimë se ndërtimi i një shtëpia kushton më shumë se 5,000.00 €, prandaj ne e përshëndesim shoqatën Jetimët e Ballkanit që ka shpreh gatishmëri që ti ndihmojë një pjesë të qytetarëve të komunës sonë. Prnadj edhe ne si grupi i LDK-së e përkrahim këtë iniciativë.

**Ali Morina** – I nderuari kryesues desha një sqarim sa i përket anëtarëve të komisionit, në këtë vendim e kemi të cekur: 1. Kryesuesi i komisionit, 2. Anëtar nga kuvendi, 3. Anëtar nga ekzekutivi, 4. Anëtar nga shoqëria civile dhe 5. Anëtar nga shoqata Jetimët e Ballkanit. Kryesuesin a e propozon ekzekutivi i cili e ka një vend, apo e propozon kuvendi i cili edhe ai e ka një vend, mendoj se kjo është dashur të specifikohet. Kurse sa i përket marrëveshjes edhe ne si grup i AAK-së jemi pro kësaj marrëveshje.

**Isak Hoti** – Të nderuar 2 anëtar janë nga kuvendi, kam mundur pozitën e kryesuesit të lë në fund apo në mes, por më ka shkuar dora dhe e kam lënë në fillim. Kështu që dy anëtar janë nga kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile, të gjithë këta anëtar e zgjedhin vetë kryesuesin e grupit.

**Ali Zhuniqi** – Edhe ne grupi i Vetëvendosjes i mbështesim aktivitetet humanitare, përndryshe e përgëzoj z. Halil Kastratin dhe kryetarin e komunës, i uroj familjeve në nevojë ndërtimin e shtëpive, por dashtë zoti që mos të ketë më nevojë askush për mbështetje të tilla.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për diskutimet e bërë, tani është koha që të jepni emrat për anëtar të komisionit.

**Ali Morina** – Ne grupi i AAK-së e propozojmë z. Artan Zenuni.

**Rasim Fazliu** – Ne si grupe i PDK-së propozojmë z. Refki Kryeziu.

**Dervish Çadraku** - A kemi të drejtë të i propozojmë më shumë se dy anëtar të kuvendit, nëse po atëherë ne VV-ja e propozojmë znj. Shqipe Kryeziu.

**Sali sallteku** - Të nderuar ne jemi duke kërkuar që të i mbajmë dy mbledhje në muaj, edhe pse njëra nuk paguhet, nuk janë shumë pika edhe këto sot që i kemi nëse shkojmë pa i diskutuar shumë, sepse ka pika që diskutojnë disa perona për gjërat e njëjta pa nevojë. Tani munden edhe këta të LDK-së të propozojnë emra dhe të shkojë gjatë kjo pika pa pikë nevoje, z. Dervish Çadrakut nuk i takon sepse janë pak në numër ne jemi më shumë dhe na takon neve.

**Dervish Çadraku** – Është e drejta e jona dhe askush nuk ka nevojë të na tregoj neve se a kemi të drejtë apo jo, pastaj ju shumica vendosni vetë atëherë pa neve.

**Fehmi Cena** – Nëse shkojmë me marrëveshje me dy veta atëherë ne rregull mundemi të mëremi vesh ne grupet parlamentare, por nëse shkojmë kështu me propozime atëherë edhe ne e kemi kandidatin tonë.

Propozimi imë kishte me qenë që dy nga kuvendi të jenë nga opozita, sepse ekzekutivi e ka përfaqësuesin e vetë, me këtë do të kemi një përfaqësim më të gjerë.
**Kryetari** – Unë gjithsesi se pajtohem, po ashtu pajtohem se do të ndërtohen 7 shtëpi në komunën tonë për njerëzit në nevojë, po ashtu edhe 3 shtëpi shtesë shoqata Jetimët e Ballkanit e ka mare përsipër se do i ndërtojë betë me mjetet e tyre, pra gjithsej 10 shtëpi. Nëse ju pajtoheni që të jeni të gjithë pjesë e komisionit atëherë unë propozoj që të jenë 7 anëtar të komisionit, por nëse pajtoheni me z. Sali salltekun se duhet të i biem shkurtë atëherë unë po e tërheq z. Artan Zenunin, dhe lërjani këtyre grupeve më të vogla.
**Refki Kryeziu** – I nderuar kryesues unë tërhiqem nga ky komision dhe ja lë hapësirë partive më të vogla që të përfaqësohen.
**Dervish Çadraku** – Sa bura të mirë jeni duke u bërë tani sepse ky komision nuk është me pagesë, nuk është problem tani edhe ne tërhiqemi por nuk është e drejtë.
**Artan Zenuni** – Përshlndetje për të gjithë, i nderuari kryesues edhe unë po tërhiqem dhe po ja lëmë vendin partive më të vogla si LDK-së dhe VV-së.
**Masar Popaj** – Ne grupi i LDK-së propozojmë Faton Ramadani, kurse sa i përket asaj që e thoni se LDK-ja si pari e vogël, mos harrini se edhe ju tani jeni bërë të barabartë me PDK-në, kështu që besoni se ju do të shkoni duke u zvogëluar kurse ne duke u rritur.
**Kryesuesi** – Pra u sqaruam tani kemi këto emra për anëtar të komisionit: Nga kuvendi nga radhët e LDK-së z.Faton Ramadani, nga radhët e VV-së znj. Shqipe Kryeziu, nga ekzekutivi Samir Mustafa, nga shoqëria civile nga SHL – Kosova znj. Vjollca Gërguli. E qes në votim marrëveshjen në mes kryetarit dhe shoqërisë Jetimët e Ballkanit dhe anëtarët e komisionit: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:
**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi".**
**Bjondina Kleqka** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para vete e keni një propozim vendim për krijimtarinë letrare dhe artistike Sulejman Krasniqi, ky çmim propozohet me qëllim që të ju ndahet të gjithë atyre që kanë kontribuar rreth kulturës, dhe ruajtjen e vlerave të traditës kombëtare. Vlera e çmimit letrarë Sulejman Krasniqi do të jetë 500.00 €, dhe ky çmime do të ndahet për ditën e bibliotekës Sulejman Krasniqi. Ju ftojë që ta përkrahni dhe votoni këtë propozim vendim.
**Fahrije Lushi Morina** – Së pari kjo është njëra nga mënyrat më modeste nga ne si komunë që të tregojmë një respekt dhe një traditë të mirë, ndoshta tipike falënderuese ndaj vlerave dhe veprimtarisë letrare dhe artistike të cilën e përmban veprimtaria letrare e Sulejman Krasniqit. Urojë që gjithmonë të i përkrahim dhe nderojmë shkrimtarët të cilët vinë nga komuna jonë, të cilët besoj se nuk janë të paktë„ po ashtu mirë do të ishte që edhe për së gjalli të i nderojmë, pasi me Sulejman Krasniqin nuk e patëm këtë mundësi.
**Rasim Fazliu** – Gjithsesi që edhe ne jemi pro këtij propozim vendimit për ndarje të këtij çmimi, ky çmim i bënë vetëm nderë komunës së Rahovecit duke u bazuar në figurën madhore që e ka pasur Sulejman Krasniqi.
Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi": Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:
**7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec.**
**Kryesuesi** – Me kërkesë të anëtarëve të kuvendit, po e qes në votim edhe pikën Propozim vendimin e kryetarit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, pasi ka të bëjë me të njëjtën çështje: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar edhe pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

**8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2019 – 2023.**
**Isak Hoti** – Draft plani për transparencë komunale për herë të parë është për katër vite,, këtu ka punuar një grupe punës i cili është formuar nga kryetari i komunës, nëse keni ndonjë vërejtje ose ndonjë sugjerim rreth këtij plani vetëm sa e plotësoni dhe e bëni më të plotë këtë plan.
**Faton Ramani** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa in përket kësaj pike desha të japë pak kontribut, në faqe nr. 2 të këtij plani është cekur se mbledhjet e kuvendit do të përcillen online përmes faqes zyrtare të komunës, nga MAPL-ja dhe kanalit youtube. Mendoj se kishte me qenë mirë të ceket se mbledhjet janë duke u përcjellë edhe nga radio aktivi.
**Haziz Krasniqi** - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kjo është bërë edhe për komunat e tjera, dhe në asnjë komunë nuk është cekur ndonjë radio apo televizion, edhe pse komunat e tjera kanë radio lokale dhe televizione lokale. Po ashtu edhe në rregulloren për transparencë që shumë shpejtë do ta keni në kuvend nuk është paraparë, prandaj nuk e kemi parë të arsyeshme të vendosim këto radio lokale, dhe as portalet e tjera që janë në nivel komune.
**Kryesuesi** – E qes në votim Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2019 – 2023: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tetë (8) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:
**9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve në komitet.**
**Isak Hoti** – Kjo kërkesë ka ardhur nga koordinatorja znj. Gabibe Haxhimustafa, ne sot këtë e kemi sjellë në kuvend për të zgjedhë panelin për themelimin e Komitetit me persona me aftësi të kufizuar. Të njëjtën kohë do të hapet konkursi ku do të aplikojnë njerëzit, mandati i tyre është 3 vjetarë, detyrat e tyre i kanë të cekur në vendim.
**Kryesuesi** – Të nderuar për formim të këtij komisioni neve na duhen tre emra të anëtarëve nga kuvendi.
**Rasim Fazliu** – I nderuar kryesues ne grupi i PDK-së e propozojmë znj. Afërdita Thaqi.
**Ali Morina** – Ne grupi i AAK-së e propozojmë znj. Besmire Bytyçi.
**Hanalora Hoti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne grupin i LDK-së propozojmë Mirjeta Krasniqi.
**Kryetari** – Nga ekzekutivi propozojmë z. Artan Asllani, kurse nga shoqëria civile Haxhi Hoxha.
**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin për Themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve në komitet: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e nëntë (9). Kalojmë në pikën e radhës:
**10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë.**
**Artan Asllani** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kryetarit i komunës i propozon kuvendit të komunës së Rahovecit që të merë vendimin paraprak për ndërtimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë e klasit të gjashtë në tokë ndërtimore për zonën ekonomike. Qëllimi i ndërrimit të kësaj toke është krijimi i zonës ekonomike, siç e dini komuna e Rahovecit që nga viti 2001 ka qenë në përpjekje për krijimin e zonës ekonomike mbi fshatin Opterush, por kjo ka pasur pengesë nga agjensioni pyjor i Kosovës nuk a mundur të vazhdoj me procedurat e tjera drejt licencimit të kësaj zone. Pas vendimit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës që e ka marrë me datë 22 qershor të viti 2018 për krijimin e zonës ekonomike në fshatin Opterush ju është dhënë Komunës së Rahovecit, pas këtij vendimi ne kemi vazhduar me kompletimin e dokumentacionit dhe për licencim të zonës ekonomike në këtë lokacion. Dri më tani i kmei kryer të gjitha pëlqimet që kanë qenë kriter për licencim të kësaj zone ekonomike qoftë nga ministritë përkatëse ose nga komisionet kompetentë. Tani jemi në fazën e fundit për licencim, por si kriter tjetër i Ministrisë së Tregtisë është që kjo të jetë edhe pikë e rendit të ditës në kuvendin komunal të Rahovecit dhe të merret një vendim për nderim të destinimit nga toka kullosë në tokë ndërtimore. Ju ftojë të gjithëve që ta përkrahni këtë propozim vendim.
**Ali Zhuniqi** – Këtu i keni cekur 34 hektar 89 ari, më duke goxha një pjesë që le të nënkuptohet se një pjesë e madhe e pyjeve do të dëmtohen në këtë zonë.

**Munib Durguti** – Pëlqimet të cilat i ceku drejtori se janë mare nga ministritë relevante, ne në material nuk i kemi mungojnë, pasi jemi duke mare një vendim të rëndësishëm ku përfshihen më shumë se 34 hektar, kërkoj që herrave tjera me lëndë të ngjashme të kemi një material ma të kompletuar.
**Kryetari** – Të nderuar të gjitha pëlqimet janë, materiali nuk ka pasur nevojë fare të vije në kuvend sepse zona ekonomike është themeluar, ne sot këtu jemi duke kërkuar licencim të zonës ekonomike, që do të thotë ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e infrastrukturës së zonës ekonomike. Janë diku 9 milion euro që i ndanë Qeveria e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë për zonat ekonomike. Pra materialit i mungon vetëm ky vendim që të jetë i kompletuar.
**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dhjetë (10) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:
**11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 në vendin e quajtur Rakita – Xërxë, kompanisë "NTP Vëllezërit Morina".**
**Rumir Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, me datë 20.03.2019 z. Fadil Morina pronar i kompanisë Vëllezërit Morina ka parashtruar një kërkesë për marrje të pëlqimit në Drejtorin e Urbanizmit. Kërkesa është bërë me qëllim të vazhdimit të procedurave për licencimin e kompanisë së tij në komisionin e pavarur për minierave dhe mineraleve, për aktivitetin e prodhimit të betonit dhe rërës. Parcela për të cilën ka kërkuar të pajiset me pëlqim është pronë private dhe gjendet në zonën kadastrale në Xërxë, por parcela është në kuadër të zonës së mbrojtur e cila është e shpallur nga kuvendi komunal në vitin 1986. Andaj Drejtoria për Urbanizëm i propozon kuvendit që kompanisë Vëllezërit Morina të i jepet pëlqimi për ushtrimin e aktivitetit të tije ekonomik në atë parcelë, pasi pronari nuk e ka ndonjë parcelë tjetër ku mundet të i dislokojë mjetet e tij të punës. Propozimi ynë është që pëlqimi të i jepet në një afat prej 5 viteve me mundësi që të ndryshohet nga ana e kuvendit të komunës së Rahovecit.
**Fehmi Hoxha** – I nderuari drejtor është bërë një gabim në propozim vendim sepse e keni cekur si propozues Drejtorin e Urbanizmit, asnjë drejtori në ekzekutiv komunal nuk ka të drejtë të i bëjë propozim kuvendit komunal për miratim. Drejtoritë i bëjnë propozim kryetarit të komunës në bordin e drejtorëve, nëse kryetari ja aprovon atë propozim atëherë në kuvend vije propozim vendimi nga ana e kryetarit të komunës. Të gjithë operatorët ekonomik dhe këta shfrytëzues, ku këtë vit është potencuar pak më shumë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. E tha edhe drejtori se kjo është zonë e mbrojtur e përcaktuar në vitin 1986, me ligjet e reja të Kosovës është dashur të bëhet rikategorizimi i zonave të mbrojtura, në vitin 2015 propozim vendimi i ish kryetarit të komunës z. Idriz Vehapi ka ardhur në kuvend ku pastaj kuvendi ka marrë vendim për rikategorizimin e zonës së mbrojtur që është në dy pjesë kadastrake Xërxë dhe Gexhë. Pas marrjes së vendimit Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinorë, respektivisht instituti për mbrojtjen e monumenteve natyrore i cili është përgjegjës për kategorizim dhe rikategorizim të zonave të mbrojtura ka ka formuar një komision me përbërje pre 8 anëtarëve, ku është punuar 18 muaj. Pas raportit të parë që ju është dhënë përbërjes së kuvendit të kaluar, kuvendi ka mare pastaj vendim për hapjen e debatit publik, ku pastaj janë zhvilluar debatet publike në atë zonë si në Xërxë, dhe pjesët e tjera. Pas përfundimit të debatit publik është mare vendim përsëri nga kuvendi për hapjen e shqyrtimit publik, është bërë shqyrtimi publik, është bërë raporti përfundimtar dhe pastaj është dërguar në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Pastaj kjo ministri e ka përgatitur një draft të tyre si përgjegjës për kategorizim dhe rikategorizim, por pasi ishte fushata zgjedhore ka mbetur, por nuk është anuluar, por nuk është votuar ai propozim vendim. Arsyeja pse e shtëllova këtë është se e pashë që në propozim e keni propozuar që ti jepet për 5 vite, të nderuar PZHK-në e keni në përfundim e sipër, unë kam një propozim tjetër dhe kjo nuk ka të bëjë as për një vit as për dy dhe as për pesë vite. Duke u bazuar dokumente ligjore dhe në procedurat e komunës që vazhdimisht është duke i zhvilluar, është mirë që të merret një vendim sot që ti ndihmohet të gjithë operatorëve aty ku kemi mundësi, por të merret vendim deri në miratimin përfundimtar të PZHK-së dhe Hartës Zonale, pra mos të përcaktohen vitet.

**Kryetari** – Falënderoj z. Fehmi Hoxhën për kontributin që e dha, por më duket se ne e kemi një paqartësi këtu, këtu bëhet fjalë për pëlqim për një parcelë që është e mbrojtur me ligj, të gjitha ato që i tha kuvendari i nderuar përbërja e kaluar të gjitha ato janë kryer, por nuk e ka zgjeruar zonën sepse nuk ka pasur votim në kuvend. Pastaj propozimi i drejtorit të urbanizimit natyrisht se nuk vije në kuvend pa miratimin gojorë ose formal të kryetarit të komunës. Ju e dini se përbërja e kaluar e kuvendit këtij operatori ja ka dhënë pëlqimin për vazhdimin e veprimtarisë për 1 vit po në këtë parcelë që ne sot jemi duke diskutuar, ajo është zonë e mbrojtur, por këtu nuk bëhet fjalë për dhënie enë shfrytëzim, tani jemi në situatën ku ende nuk është miratuar ende PZHK-ja, jemi në prag të përfundimit të PZHK-së, jemi në proces të hartimit të Hartës Zonale. Prandaj ne e kemi lënë në pikën e katërt të propozim vendimit që sipas nevojës kuvendi komunal mundet të revokojë pëlqimin, pra nëse ne do të kemi ndonjë shkele ligjore atëherë MAPL-ja është ajo që na kthen përgjigjen se a është i ligjshëm vendimi të cilin ne e kemi marrë sot. E mbështesë propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit, ju siç e dini ju është ndaluar veprimtaria të gjithë operatorëve që mirën me zhavorre, ne tani e kemi një situatë bukur interesante. Unë jam takuar edhe me shefin e KPMM-së i cili ka qenë në komunën tonë, ne si komunë jemi të obliguar qeti japim pëlqim mjedisor, por ne ja kemi dhënë disave që janë me pronat e agjesnionit pyjor etj, por për këtë nuk kemi mundur pa kuvend sepse kjo parcelë mbrohet me ligj. Ju ftojë që të përkrahni këtë propozim vendim kështu siç e kemi sjellë në kuvend.
**Rasim Fazliu** – Mendoj që nga fillimi në komunën tonë nuk ka funksionari inspektorati, sepse përderisa thuhet se është zonë e mbrojtur atëherë nuk është dashur në këtë zonë të lejohet të ndërtohen ndërtimet e tilla, pra është një gabim kronologjik. Ne edhe në mandatin e kaluar ja kemi dhënë pëlqimin për një vit, tash po na del se duhet përsëri të merremi me këtë problem, unë mendoj se edhe atëherë është bërë gabim që ju është dhënë për 1 vit, kurse gabimi më i madh i kësaj qeverie është se ka ardhur me një propozim për 5 vite. Zotëria në fjalë kur ju është dhënë pëlqimi për një vit është dashur ta zgjedh problemin, por unë e kuptoj se çka është duke ndodhur, kjo është një zhegitje që ai të ushtroj veprimtarin vetë. Ne me disa të tjerë jemi dakorduar që mos të shkojmë me propozimin për 5 vite, por propozimi ynë është që ti i jepet mundësia edhe për 2 vite, besoj se për këto vite do të bëjë diçka, ose do të bëjë zhvendosjen e atyre mjeteve nga ai vend.
**Kryetari** – E kuptoj anëtarin e kuvendit z. Rasim Fazliu ka të drejtë rreth shqetësimit të tij, por i nderuar është situata kështu, nëse ai nuk do të kishte pëlqim ai atëherë vazhdimisht do të dënohej nga inspektorati ose do të rinte i mbyllur ky biznes. Kompletimi i lëndës për marrje të licencës nga KPMM-ja i duhet kohë më së paku deri në 9 muaj, pra një procedurë të tej zgjatur të organeve të tjera të cilat i monitorojnë punët e resurseve minerale. Prandaj sa më pak vite ja japim pëlqimin mendoj se do të ketë më shumë probleme, edhe fundi fundit kjo është vetëm pëlqim, ne e kemi të cekur në nenin 4 të vendimit, se kur i duhet komunës mundet ta revokojë këtë vendim.
**Vahid Krasniqi** – Në momentin që është ardhur si pikë e rendit të ditës, kam filluar që të interesohem për këtë pikë, jo që e njohë pronarin e kësaj kompanie, por më ka rënë të punoj në këtë drejtim. Kolegu z. Fehmi Hoxha e shpjegoi në detale, por ashtu edhe z. Rasim Fazliu e ka me të drejtë që e tha se që nga fillimi ka shkuar gabim kjo punë sepse nuk është dashur as të ndërtohet, por ne nuk kemi çka të bëjmë sepse kjo është bërë tani. Sa jam i informuar ky operator i ka së paku 20 punëtor, po ashtu jam në dijeni që e ka pas një pëlqim për 1 vit. Po ju tregoj se si shkojnë procedurat, pasi e merë ky pëlqimin nga komuna, ky duhet të bëjë kërkesë në Ministrin e Bujqësisë, pasi është tokë bujqësore, dhe sipas informatave pëlqimi nga kjo ministri vonohet deri në 9 muaj, pas kësaj ai duhet të shkoj tek agjensioni i KPMM-së, që të aplikoj për licencim. Në mandatin e kaluar ju është dhënë pak për 1 vit, por edhe tani që ishin disa propozime për 2 vite është pak, mendoj se propozimi prej 5 viteve është i arsyeshëm sepse pika 4 e vendimit shumë mirë e definon, se komuna e Rahovecit në rast që sheh interesim të përgjithshëm publik, mundet të ja revokojë pëlqimin këtij operatori.
**Munib Durguti** – Natyrisht se jemi për të i dhënë pëlqimin, pasi që operatori e ka pas një pëlqim ë herët, mendoj se nuk është e drejtë që ti ndalohet veprimtaria biznesore në pronën e vetë, pa marrë parasysh që kjo zonë është e mbrojtur me ligj. Ne sot kemi me mare një vendim dhe ky vendim nuk dallon ashe me atë vendim që do të marrim për PZHK-në, në aspektin ligjor është i barabartë, kjo situatë mundet të prodhojë

kontradikta me PZHK-në sepse do të kemi dy vendime të kuvendit të cilët nuk përputhen njëra me tjetrën, kjo është situatë hipotetike sepse ka mundësi të përputhet, por edhe mos të përputhet. Sa i përket pikës së 4 që është e cekur në vendim, mendoj se kjo pikë nuk duhet të figurojë fare në vendime sepse nënkuptohet se edhe ligji e jep atë të drejtë dhe kuvendi në secilën kohë mundet dhe ka të drejtë të i revokojë vendimet e veta. Unë e mbështesë propozimin që e dha z. Fehmi Hoxha, që ne të i japim pëlqimin deri në aprovimin e PZHK-së, pra të futet edhe kjo pikë shtesë në vendim, pastaj të shikojë kuvendi se a është në përputhje me PZHK-në ky vendim.
**Kryetari** – I nderuar neve na është prezantuar Drafti i PZHK-së, është paraparë zgjerim i zonës ndërtimore, tani kuvendi mundet të vendos ndryshe të mëremi vesh, ne i kemi dy ose tre rrugë ose duhet të i legalizojmë ato objekte ose duhet të i rrënojmë të gjitha ose duhet të zgjerojmë zonën ndërtimore. Mendoj se kuvendi i komunës më shumë do të shkojë nga ajo që të bëhet zgjerimi i zonës ndërtimore sepse ne jemi duke jetuar në një realitet ku vështirë është me e pa një revolucion të tipit klasik, ku do të hymë me buldozera që ti rrënojmë të gjitha. Mundet të futet edhe ajo që e propozoi z. Munib Durguti, por nëse ky kuvend ka të drejtë të revokimit të vendimit edh nëse shkruan edhe nëse nuk e shkruan atë që e propozuat, mendoj se ne asgjë nuk humbin në këtë situatë, por vetëm i japim mundësi një operator që të pajiset me licencë.
**Dervish Çadraku** – Mendoj se aty ku mungon ligji aty pastaj dalin hapësira ku munden të veprojnë individët ose subjektet e ndryshëm, sikurse që e tha edhe kryetari në kohën e komasacionit, një pjesë e tyre është keqpërdorur, kjo do të thotë se atëherë ose ka pasur mungesë të ligjit ose nuk janë njoftuar njerëzit për këtë ligj, ose ka qenë neglizhencë e komunës dhe institucioneve të tjera kompetente ku është dashur të i ndalojnë ato veprime që kanë ndodhur. Nëse ne veprojmë ashtu siç e tha Kryetari dhe disa të tjerë që janë këtu, atëherë po na del se njëjtë jemi duke vepruar sikurse atëherë që e kemi lejuar të veprojnë. Nëse kodra e Gradishit së bashku me kompleksin këndej është embleme e komunës dhe zonë e mbrojtur, dhe pikë referuese e komunës së Rahovecit dhe e njerëzve të cilët vinë të vizitojnë këtë pjesë atëherë ne duhet të mbrojmë këtë pjesë. E di që ky njeri dhe ky subjekt i ka rreth 20 punëtor dhe ndoshta e dëmtojmë, por pikërisht për shkak se e kemi lënë deri tani kështu ai do të vazhdoj ende kështu, dhe nëse nuk e ruajmë këtë zonë ne jemi përgjegjës. Nëse ju kujtohet në mandatin kur kam qenë unë drejtor kemi dashur në një pjesë të Gradishit të bëjmë një pikë grumbulluese të mbeturinave, por kanë ardhur dhe na kanë thënë që nuk bënë sepse kjo është zonë e mbrojtur. Propozimi imë është që të i japim kohë 2 - 3 vite, por kurrsesi 5 vite, me këtë do të dalim para ligjit dhe qytetarëve që jemi duke e mbrojtur ambientin, nëse ja lëmë PZHK-së atëherë mendoj se ky plan edhe 10 vite ndoshta nuk bëhet.
**Kryetari** – Të nderuar kriter nga KPMM është nëse donë dikush të pajiset me dokumentacion atëherë duhet të ketë afat 5 vite, për këtë arsye ai nuk ka pasur se si të pajiset, ai duhet të ketë pëlqim 5 vite në mënyrë që të ketë rastin që të vazhdojë më tutje. Edhe një herë po ju them ne e kemi të drejtën me e hekë kur të dëshirojmë, por ne duhet të ja japim rastin atij që të shohim se a do të mundet ai të e zgjidhë rastin me KPMM-në, nëse jo atëherë ne jemi këtu. Ju ftojë që të votoni për 5 vite, mendoj se propozim vendimi është i arsyeshëm dhe të drejtat e rezervuara i ka kuvendi i komunës së Rahovecit.
**Rexhep Oruçi** – Me vetë faktin se kjo pikë e rendit të ditës na ka mare goxha kohë, ku kemi debatuar në mënyrë konstruktive dëshmon se është interesi edhe i qytetarëve por edhe i komunës në përgjithësi dhe në veçanti të një operatori ekonomik. Siç dëgjuam ky person i ka 20 punëtor mendoj se komuna vetëm që ja sheh hairin sepse paguan tatime dhe kontribute. Këtu kishte disa propozime, dikush 2, dikush 3 vite, unë për vete jam që ti vazhdohet për 5 vite, për arsye se atij i duhet kjo kohë për tu pajisur me licencë. Nëse ndryshohet PZHK-ja dhe nëse dele në kundërshtim me PZHK-në atëherë ky vendim revidohet, është mirë që kjo një herë e mirë të kryhet puna me gjithë atë rajon, janë propozimet nga niveli qendrorë se si duhet të kryhet kjo punë, prandaj unë si Rexhep Oruçi jam pro që ti jepet për 5 vite.
**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë e qesim në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që pëlqimi për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 në vendin e quajtur Rakita – Xërxë, kompanisë "NTP Vëllezërit Morina" ti vazhdohet vetëm për dy vite: Konstatoj se me 10 vota kundër, 8 vota pro nuk u aprovua propozimi z. Rasim Fazliu. Tani të nderuar kuvendar e qes në votim Propozim vendimin për

dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 në vendin e quajtur Rakita – Xërxë, kompanisë "NTP Vëllezërit Morina": konstatoj se me shumicë votash është aprovuar pika e dymbëdhjetë (12) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma" Rahovec.**

**Isak Hoti** – Zyra ligjore ka hartuar rregulloren në fjalë, debati publik është mbajtur me datë 15.04.2019, në këët debat kanë mare pjesë vetëm anëtarët e grupit të futsallit, askush tjetër pos tyre. Kjo rregullore gjithsej i ka 17 nene, duke përfshirë qëllimin, përkufizimin, funksionimin e palestrës sportive, strukturën organizative të objektit sportiv, mirëmbajtjen e palestrës, investimet kapitale, pastaj e drejta për shfrytëzim të palestrës, mënyra e shfrytëzimit të palestrës, kërkesat për shfrytëzim, orari i shfrytëzimit të palestrës sportive, rregullat themelore për shfrytëzimin e palestrës sportive, e drejta e sponsorizimit, dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzimin e palestrës sportive, pagesat e shfrytëzimit të objektit të palestrës, masat ndëshkuese, rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit, zbatimi i rregullores dhe hyrja në fuqi e palestrës. Gjatë debatit na ka dalë një kërkesë që nga biletat të hyrat për komunë të jenë 30% edhe pse propozimi i kryetarit është të jetë 20%. Debati më i ashpër po dele të jetë tek e drejta e sponsorzimit, ndoshta edhe është keq interpretuar, reklamat brenda palestrës që janë statike janë reklama që do të paguhen në buxhetin e komunës, reklamat lëvizëse dhe reklamat elektronike janë reklamat që shkojnë drejtpërsëdrejti tek klubi që e organizon lojën. Të nderuar anëtar të kuvendit ju jeni ata që do të jepni verdiktin e fundit sepse kjo rregullore votohet nga ju, propozimet, sugjerimet e juaja vetëm sa e pasurojnë këtë rregullore, qëllimi ynë është që të dele sa ma mirë kjo rregullore për sportdashësit e komunës së Rahovecit. Mos të harrojmë se kjo palestër ka edhe koston e mirëmbajtjes, sipas informatave që i kam mare në drejtorin e financave për muajin shkurtë dhe mars pa e llogaritur ngrohjen janë paguar vetëm rrymë 1,300.00 €. Dhe këto të hyra që i inkason komuna nga kjo palestër shkojnë vetëm për mirëmbajtje të palestrës.

**Kryesuesi** – Është fati i madhe që më në fund edhe Komuna jonë është bërë me palestër sportive, ku të rinjtë tanë kanë mundësi që ti zhvillojnë aktivitetet sportive, prandaj është e domosdoshme që të kemi rregullore për palestër.

**Vahid Krasniqi** – Tek e drejta e sponsorizimit, të drejtën ekskluzive për sponsor kryesor tek pamjet e palëvizshme në parket i takon një sporti që është më i suksesshëm, ne në këtë raste e kemi basketin. Kjo rregullore është mare shabllon edhe nga komunat e tjera, dhe sponsoret e tjerë klubet munden të i përdorin gjatë ndeshjeve, kur të përfundoj ndeshja reklamat e tyre hiqen, mendoj se gjithçka është e qartë këtu.

**Munib Durguti** – Do të fokusohem tek neni 4 tek struktura organizative e objektit sportiv, tek pika 2e këtij neni ceket se struktura organizative për menaxhimin e objektit sportiv përbëhet nga zyra administrative e palestrës, kujdestari e kështu me radhë, ne tekst më poshtë ceket edhe menaxheri i palestrës. Prandaj propozoj që pika 2 të plotësohet dhe të fillohet nga menaxheri i palestrës dhe të vazhdohet pastaj me zyrat administrative e me radhë.

**Fehmi Hoxha** – Është mirë që është precizuar kjo rregullore, po ashtu mirë që janë cekur tarifat për çdo pjesë që duhet të shfrytëzohet palestra, por një gjë duhet të kemi ne të qartë se bizneset në komunën e Rahovecit janë një ndër bizneset më të ulëta dhe me mundësi më të paktë për sponsorizim, bizneset në Komunën e Rahovecit më së paku sponzorizojnë sportin dhe kulturën. Prandaj propozoj që të gjitha tarifat që janë të cekur për sponzorizim të zvogëlohen për 30% me të vetmin qëllim që sa më shumë biznese të kemi të involvuar në sporte. Të nderuar ne nuk mundemi të krahasohemi në fushën e biznesit dhe zhvillimit ekonomik me komunat e tjera sikurse që është Gjilani ose Suhareka, prandaj e dhashë këtë propozim që taksat të zvogëlohen për 30%. Po e citoj nenin 11 pika 7.8: Transmetimi i ngjarjeve në palestër nga kompanitë televizive në raste se nuk janë të ftuara nga subjektet, dua një sqarim se cili është subjekti në këtë rast, a është ekipi i cili i zhvillon garat, apo është Drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport. Pastaj pika 8 shpenzimet e shkrimit, vendosjen dhe zhvendosjen e reklamave i batë subjekti i cili i ka vendos reklamat, mendoj se duhet të shtohet edhe një pikë shtesë dhe të ceket se kush e bartë shpenzimet në raste se dëmtimin e bëjnë shikuesit. Pastaj pika 13: Në raste kur paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklama në të njëjtin

vend përzgjedhja bëhet me licitacion, a kemi ne të drejtë një gjë të tillë me e bë ( Oferta dhe kërkesa më të favorshme komerciale), a duhet të formohet ndonjë komision apo duhet ekzekutivi të merret me këtë. Tek neni 12: Klubet sportive për zhvillimin e aktiviteteve të tyre sportive duhet të i sjellin tek menaxheri i palestrës këto dokumente, a do të kemi ne menaxher të palestrës, sepse aktualisht kemi shefin e sportit.

**Refki Kryeziu** – Desha të ndërlidhem rreth nenit 13 pika 1.6 të kësaj rregullore ceket: Për zhvillimin e ndeshjes me bileta 30% e mjeteve të nkasuara nga shitja e biletave derdhen në llogarinë e komunës, pjesa tjetër prej 70% derdhet në llogarinë e shfrytëzuesit të palestrës. Propozimi imë është që shuma prej 30% e inkasimit që shkon për komunën të hiqet, dhe të ceket një shumë fikse prej 100.00 € që ti paguhet komunës për një ndeshje. Po ashtu edhe sponsorizuesit është mirë që mos ti ngarkojmë me këto tarifa, sepse ata janë ata që e mbajnë klubin, tek vendosja e reklamave i bie që sponsorizuesit të bëjnë marrëveshje me komunën dhe jo me klubet.

**Isak Hoti** – Po i përgjigjem z. Fehmi Hoxha, tek shpenzimet në raste dëmtimit të palestrës nga shikuesit i bartë drejtpërsëdrejti organizatori. Kurse tek pika 13 sa i përket licitacionit a kemi të drejtë, po i nderuar ne kemi të drejtë, edhe ofertat për ankand publik jemi duke i bërë njëjtë për shfrytëzimin e hapësirave publike, shkon me ofertë ai i cili jepe çmimin më të lartë ai e fiton. Sa i përket menaxherit të sallës, ne qysh në fillim e kemi diskutuar se menaxheri dhe stafi teknik duhet të plotësohet, zyrtarët që janë për momentin janë transferuar përkohësisht, por nuk mundemi të i bartim për çdo herë. Komuna e ka për obligim të i hapë vendet e lira të punës dhe në palestër të plotësohet stafi. Tek çështja e 30%, mos harroni se ka me pas raste edhe organizim të koncerteve, organizatori vjen fiton nga koncerti kurse ne duhet të paguajmë të gjitha shpenzimet, rrymën, pastrimin, ndonjë dëmtim eventual etj. Por prapë ju jeni ata që vendosni sepse ju jeni kuvendit dhe ju e votoni, por ne e kemi cekur më lartë edhe në ato organizimi që nuk ka bileta çmimi i shfrytëzimit është 30.00 €, kurse aty ku ka bileta e kanë propozuar 30%. Por realisht 20% është standard nga shumica e komunave, por ka komuna që e kanë edhe 30%, p.sh Suhareka e ka 30%, Gjilani 30%, por ne pasi jemi komunë më e vogël mundemi me e lënë me 20%.

**Vahid Krasniqi** – Kisha propozuar që 30% të hiqet për klubet, për arsye se klubet tani janë të gjitha fillestare, përpos basketit, do të keni mjaftë vështirësi që të mbijetojnë, të gjitha klubet mendojnë që të kenë hyrje me bileta në mënyrë që me ato të hyra të mbijetojnë. Kurse për organizim të koncerteve dhe organizime tjera të mbetet shuma prej 30%.

**Kryesuesi** – Të nderuar me të vërtet kemi organizim të garave, ku klubet tona sidomos basketbolli i cili tani për momentin është duke korrur suksese, shpresojmë edhe sportet tjera, kishte me qenë mirë që nëse është mundësia që të lëvizim pak përqindjen dhe të jetë 20%, ky është edhe propozimi imë: Nëse në një ndeshje janë 100 shikues të pranishëm atëherë edhe komuna asgjë nuk përfiton dhe i bie që të gjitha shpenzimet të i bien në kurriz të komunës, nëse nuk punon ndonjë poqë në palestër bëhet bukur alarmante, pastaj ngrohja e sallës dhe për këtë dikush duhet të kujdeset dhe kjo ka koston e vetë goxha të madhe. Por nëse salla mbushet si në këto ndeshje atëherë me këtë ka përfitim edhe klubi, por edhe komuna duhet të mbështetet sepse duhet të merë diku mjete që të investoj pastaj në mirëmbajtje të palestrës.

**Isak Hoti** – Problem tjetër që e kemi është çështja e pastrimit, ju thash ne mundemi me e lënë pa pare, ju jeni ata që vendosni, por me qenë që ndërgjegjësohemi dhe të paktën pastrimin e sallës le ta kryejnë vetë, por gjithqysh komuna po është e obliguar që ta paguaj dike që të bëjë pastrimin e palestrës. Ju i dhatë disa propozime, dikush propozoi 30%, dikush 20%, ndaluni ka 15% pra një mes dhe ta kryejmë këtë punë, fundi fundit klubet janë tonat dhe shumë mirë që kanë mare famë, gëzohem që janë duke ecur përpara, është mirë që ju ka dhënë mundësia të rinjve të Rahovecit dhe të shohin se edhe ne jemi dikushi. Por prapë po e the ju jeni kuvendi, ju jeni ata që e ngritin dorën dhe ashtu si e ngritin ju dorën ashtë edhe do të votohet kjo rregullore.

**Refki Kryeziu** – Të nderuar kuvendarë propozimi imë është që të jetë 10%.

**Fehmi Cena** – Mendoj se çdo objekt që ndërtohet e ka koston e vetë të shpenzimit, edhe pse e dimë se për çka përdoret ne të gjithë jemi të vetëdijshëm. Mendoj se 30% të mos jetë, por edhe 10% është shumë pak, ma mirë të mos ketë fare se sa 10%, propozimi imë është 20% dhe mendoj se është shumë real. Ka kosto

sepse duhet stafi të punësohet, pastërtia duhet të jetë në nivel e jo të grumbullohen aty mbeturinat deri në gjunjë dhe të bëhet pastaj burim i infeksioneve të ndryshme, prandaj mendoj se së paku dy pastrues duhet aty të punësohen.

**Vahid Krasniqi** – Të nderuar mendoj se komunat e tjera paraprakisht i kanë pasur tarifat 10,20 edhe 30%, dhe ata kanë ardhur në përfundim se 20% ose 30% i përgjigjet kërkesave të objektit. Prandaj edhe unë kisha me thanë që mos të dalim shumë jashtë kësaj rregullore, por të shikojmë se si i kanë komunat mesatare sikurse Komuna jonë, të i përshtatemi atyre dhe ta votojmë.

**Kryesuesi** – Tani do e hedhim në votim propozimin e z. Fehmi Hoxha që komplet tarifat e nenit 11 të ulen për 30%: Konstatoj se me 16 vota për, 5 kundër dhe pa asnjë abstenim aprovohet propozimi i z. Fehmi Hoxha. Tani e qesë në votim propozimin e z. Refki Kryeziut i cili ka propozuar që tarifa e biletave që i merë komuna të jetë 10%: Konstatoj se propozimi i z. Refki Kryeziut nuk aprovohet. Tani e qes në votim propozimin e z. Afrim Dina dhe z. Fehmi Cena që tarifa e biletave që i inkason komuna të jetë 20%: Konstatoj se me 16 pro, 5 kundra dhe asnjë abstenim është aprovuar propozimi i z. Afrim Dina dhe z, Fehmi Cena. Tani të nderuar kuvendar e qes në votim Draft Rregulloren për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma" Rahovec, me ndryshimet e bëra nga kuvendarët tanë. Konstatoj se 17 pro, asnjë kundër dhe me abstenime është aprovuar pika e dymbëdhjetë (12). Kalojmë në pikën e radhës:

**13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 591 të datës 16.02.2018, për Themelimin e Komitetit për Komunitete.**

Të nderuar kuvendarë ne që një kohë e kemi vendin vakant tek Komiteti për Komunitete, pas dhënies së dorëheqjes nga znj. Bjondina Kleqka si anëtare e këtij komiteti nga radhët e AAK-së. Ju po ashtu e dini se KQZ-ja nuk ka qenë aktive deri më tani, pasi u aktivizua ne tani duhet të plotësojmë këtë komitet me një anëtare nga AAK-ja. Propozimi i AAK-së është që anëtare e këtij komiteti të jetë znj. Shqipe Tara. E qes në votim propozimin e grupit të AAK-së: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e trembëdhjetë (13) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

**14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019".**

**Afrim Limani** – Këtu kemi të bëjmë me një kërkesë të cilën na ka adresuar këshilli organizativ i Festivalit Anadrinia Jehon, ata e kanë adresuar kërkesën që kjo pagesë të bëhet në emër të subvencioneve nga zyra e kryetarit, por në mungesë të mjeteve nga kjo kategori buxhetore, kam propozuar që kjo pagesë të bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Kërkesa e tyre është në vlerën 8,500.00 €, kurse propozimi i kryetarit është që ti ndahen 5,500.00 €, por ju jeni ata që vendosni se sa mjete duhet të i ndani këtij festivali.

**Masar Popaj** – Vitin e kaluar i kemi ndarë 4,000.00 €, kurse tani kërkohet 5,500.00 €, të nderuar nuk jam kundra që ti ndahen mjetet, por ka qenë mirë nëse do ta kishim një tabelarë se për çka do të shpenzohen këto mjete, pra të kemi më shumë detale.

**Dervish Çadraku** – Mendoj se z.Masar Popaj e ka shumë të drejtë, çdo kërkesë që bëhet e këtij lloji duhet të ketë një projekt, ku ceket në tabelë se çka shpenzohet në këtë aktivitet. Ndoshta ju e keni por është dashur që edhe ne ta kemi atë tabelarë që të jemi të njoftuar më mirë se ku shkojnë këto mjete dhe me ditë se për çka jemi duke votuar.

**Munib Durguti** – Jam duke parë që ky vendim është pakës më ndryshe sikurse vendimet e tjera që i ka mare kuvendi, kuvendi zakonisht vendos për kategorinë e subvencioneve në vlerën mbi 2,000.00 €. Dilema ime është se ku e bazojmë ne këtë vendim, në këtë formë kjo nuk bënë të shkoj, për mallra dhe shërbime është një procedurë e përcaktuar që duhet të shkojë me thirrje publike, ku konkurrojnë këshillat dhe vendoset dhe pastaj shkon me marrëveshje mes kryetarit të komunës dhe këshillit organizues.

**Afrim Limani** – I nderuar z. Dervish çardaku, kjo shoqatë ka bërë kërkesë në kuadër të thirrjeve publike që është bërë në kuadër të subvencioneve, por siç e ceka më lartë kjo tani është kërkesa ime që për arsye të mungesë së mjeteve në subvencione të bëhet pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Pastaj pa mare parasysh vlerën kuvendi është ai i cili vendos, ju siguroj se kurrfarë problemi nuk do të kemi në aspekt

me ligjin nëse këtë e vendos kuvendi. Kjo shoqatë e ka sjellë raportin me përshkrimin e të gjitha shpenzimeve që do të bëhen për aktivitetet e këtij festivali.
**Dervish Çadraku** – U informova që ka konkurruar ashtu si duhet në Drejtorin e Kulturës, por unë e thash se ne është dashur të kemi materialin përpara, ne gjithqysh që do ja ndajmë mjetet këtij këshilli, por nuk e kemi materialin e mjaftueshëm, ku pastaj do të marrim vendim konform ligjit, por duhet të jetë edhe për nevojat e tyre vendim i arsyeshëm.
**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019": Konstatoj se me 15 vota pro, asnjë kundër dhe me 4 abstenime është aprovuar pika e katërmbëdhjetë (14) e rendit të ditës.
Kuvendar të nderuar ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

**Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:10**

**01 Nr. 1818**
**Rahovec, 31.05.2019**

**Procesmbajtësi**
**Skender Hamza**

REPUBLIKA E KOSOVËS Kuvendi i Komunës së Rahovecit RAHOVEC
REPUBLIKA KOSOVA Skupština Opštine Orahovac ORAHOVAC

**KRYESUESI**
**Afrim Dina**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

# RAPORTI PERFORMANCËS KOMUNALE

JANAR- DHJETOR 2018





# PËRMBAJTJA

**PËRMBAJTJA** ........ 1
Raport për Performancën Komunale Janar-dhjetor 2018 ........ 2
Fusha e parë - Shërbimet publike administrative ........ 2
Fusha e dytë -Transparenca ........ 3
Fusha e tretë- Kulturë, rini dhe sport ........ 3
Fusha e katërt- Të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale ........ 3
Fusha e pestë - Menagjimi i Fatkeqësive ........ 4
Fusha e gjashtë- Planfikimi Hapësinor Komunal ........ 4
Fusha e shtatë- Hapësirat Publike Komunale ........ 4
Fusha e tetë- Infrastruktura Lokale ........ 5
Fusha e nëntë- Transporti publik Komunal ........ 5
Fusha e dhjetë- Hapësira për parkingje publike ........ 6
Fusha e njëmbëdhjetë - Furnizimi me ujë të pijshëm ........ 6
Fusha e dymbëdhjetë- Kanalizimi ........ 6
Fusha e trembëdhjetë -Menagjimi i Mbeturinave ........ 6
Fusha e katërmbëdhjetë -Mbrojtja e Mjedisit ........ 6

## Raport për Performancën Komunale Janar-dhjetor 2018

### 1. HYRJE

Në bazë te udhëzimit të punës së sistemit të menaxhimit të performancës komuna raporton për 14 fusha gjithsej.

Udhëzimet e punës kanë për qëllim prezentimin e tregueseve të cilët përbëjnë SMP-në përkatësisht informimin e zyrtarëve përgjegjës se si janë ndërtuar treguesit edhe të cilat të dhëna janë të nevojshme për të plotësuar raportimin për secilin tregues të veçantë.

Për vitin e raportuar 01 janar-15 shkurt të vitit pasues bëhet:

- Mbledhja ,
- Verfikimi dhe
- Raportimi përfundimtar i të dhënave nga komunat në sistem elektronik.

Mapl dërgon njoftimin me pakon e dokumentave përcjellëse te koordinatori komunal, ku ky raport përbehet prej :

- Njoftimi për raportimin ,
- Dokumentimin etj.

Sistemi i SMP-së do të jetë i bazuar në aplikacionin softverik të zhvilluar enkas për sistemin e mbledhjes edhe te raportimit i cili shfrytëzon formularë elektronik të zhvilluar në Ms-Exel përkatësisht dy forma formën 1 dhe formën 2.

- Kontrollon nëse të dhënat janë transformuar automatikisht nga secili formular 1
- Në formularin 2 në formën elektronike .

Komuna raporton për 14 fusha e 65 tregues, autorizimin e të dhënave e bën kryetari i Komunës .

Treguesi 2.3.3% e diskutimit të raportit të performancës komunale nga kuvendi komunal nga viti paraprak ku kërkohet të bëhet prezentimi para datës 30 qershor .

Në vazhdim do ti'u raportojmë për 14 fusha në bazë të udhëzimit të punës së sistemit të menaxhimit të performancës .

## Fusha e parë - Shërbimet publike administrative

Te Administrata në përgjithësi kërkohet numri i lëndëve të parashtrura gjatë tërë vitit ,numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e Komunës ,problemi është tek numri i lëndëve të cilat janë të shqyrtura brenda afateve të parapara nëpër të gjitha drejtoritë ,problemi është ndoshta te Intraneti ose që drejtoritë nuk po i përditësojnë të dhënat në sistem ,në bazë të raportit që kërkohet nga performanca nga numri i gjithëmbarshëm i kërkesave duhet të kategorizohen lëndët në bazë të afateve 7 ditore,10 ditore,15 ditore ,30 ditore dhe 45 ditore varësisht nga rëndësia e lëndës ,besoj edhe shpresoj

kjo çështje të rregullohet ,edhe pse këtë vit kemi raportuar për dy fusha për 1.1 % të lëndëve të shqyrtura gjatë vitit ,dhe për 1.2 % të lëndëve të shqyrtura brenda afateve ligjore kurse për 1.3 nuk kemi raportuar sepse nuk kemi pasur të dhëna .

Kërkoj nga drejtoria e Administratës të rregullohet kjo çështje mos të na përseritet ky problem për ofrimin e shërbimëve për Administratën.

## Fusha e dytë -Transparenca

Te kjo fushë besoj së është plotësuar ku kemi edhe vlerat 100% gati se të gjitha fushat e transparencës , te fushat e sigurimit të pjesmarrësve të qytetarëve në procesin e vendimarrjes,sigurimi i qasjes së dokumenteve publike ,sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i afateve ligjore në proceset e kuvendit komunal mendoj edhe per vitin 2019 të kemi këtë rezultat .

## Fusha e tretë- Kulturë, rini dhe sport

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të ketë plan vjetor me numër të projekteve të planit lokal për veprimtaritë kulturore,rinore dhe sportive ,poashtu edhe sa janë realizuar, numri projekteve të realizuara për veprimtaritë kulturore ,rinore,sportive ,duhet të kenë të dhëna sa i takon numrit të pjesëmarrësve nëpër aktivitete të ndryshme kulturore ,sportive dhe rinore, te këto fusha ka dalë % rreth 80 % ku mendoj vetëm më me pak kujdes të realizohet plani vjetor edhe per veprimtaritë kulturore ,sportive e rinore të kemi të dhëna si numrin e pjesëmarrësve poashtu edhe realizimin e planit vjetor për këto veprimtari rinore,sportive dhe kultorore që në vitin 2019 të realizohet 100% .

## Fusha e katërt- Të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale

Duhet të raportohet numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizura në Institucione, me këtë kuptojmë për krijimin e një mjedisi jetësor që i trajton në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në instiuticione komunale dhe prej këtij numri kërkohet numri i femrave të punësura në institutcione komunale gjithashtu prej saj kërkohet numri i komuniteteve sa janë të punësuar , sa familje kanë kërkesa sa i takon strehimit dhe sa kërkesa janë të plotësura.

Gjatë vitit kalendarik 2018 asnjë kërkesë nuk është plotësuar për strehim, kërkohet numri i popullatës me numrin e përfituesëve nga skema sociale ,numrin e ankesave sociale,me numrin e ankesave të miratuara ,numrin e kërkesave të fëmijëve në nevojë për strehim familjar dhe numrin në nevojë në familjet strehuese.

Numri i pjesmarrësve në takime publike sa kanë qenë dhe numri i grave sa ka qenë në takime publike.

Numri i përgjithshëm i grave të emëruara në postet politike dhe numri i zyrtarëve të emërur në postet politike.

Duhet të raportohet para Kuvendit Komunal nga Zyra e personelit, raporti vjetor në përqindje për përmbushje (që deri më tani nuk kanë raportuar do të ishte mirë të raportojnë, gjithashtu është edhe obligim ligjor që ti plotësojmë këto të dhëna që për vitin 2017 nuk ka pas raportim.

Duhet çdo punëtor i ri që punsohet të vendoset në SIMBNJ –Sistemin informues të burimeve njerëzore.

Komuna duhet të raportojë dhe të masë kriterin e sistemit për vlerësimin e punëtorëve në bazë të formulës :

- Jo më shumë se 5 % vlerësuar shkëlqyeshëm
- Jo më shumë se 15 % vlerësuar shumë mirë
- Jo më shumë se 30% vlerësuar mire, kjo ka të bëjë me zyrën e personelit.

Unë mendoj të gjitha këtyre duhet t'iu japim rëndësi sepse i kemi vlerat më të ulëta të raportuara duke filluar nga % e të punësuarve me aftësi të kufizura ,% e përkatësive gjinore ,% e të punësuarve nga komuniteti jo shumicë ,% e grave pjesëmarrëse në takimet publike ,% e zyrtarëve publik te jenë femra ,% e familjeve në nevojë te cilave i'u është siguruar banimi, % e popullatës të skemës sociale ,% e ankesave të miratura për skemën e ndihmës sociale ,% e zbatimit të skemës në shpërndarjen e vlerësimit të punës së shërbyesve civil ,% e vendve të hapura të punës sipas SIMBNJ, % e prezentimit për diskutim në Kuvendin Komunal.

## Fusha e pestë - Menagjimi i Fatkeqësive

Duhet të ketë plan vjetor të punës dhe kërkesa është sa aktivitete apo projekte i ka planfikuar dhe sa i ka realizuar gjatë vitit kalendarik ,sa raste emergjente kanë qenë gjatë vitit dhe sa intervenime janë bërë gjatë vitit, kjo fushë mendoj që është mirë ka vlera 100% .

## Fusha e gjashtë- Planfikimi Hapësinor Komunal

Te kjo fushë ka mangësi të mëdha sa i takon planeve të hollësishme si planet urbane ,planet rregulluese ,përveç që ka një plan zhvillimor, por po presim që së shpejti të jetë gati Harta Zonale tash me ligjin e ri përveç kësaj kërkohet edhe numri i lejve ndërtimore në raport me numrin e inspektimeve nga drejtoria e Inspeksionit ku thuhet përveç që inspektori del në terren të i kërkohet leje ndërtimore palës ajo duhet ti inspekton edhe ato objekte që kanë marrë leje , kjo fushë nuk ka vlera të mira për arsye se kemi mungesë të planeve gjithashtu edhe numri i inspektimeve te lejet nuk është në nivel me numrin e lejeve ndërtimore që janë dhënë nga Drejtoria për Urbanizëm.

## Fusha e shtatë- Hapësirat Publike Komunale

Në Komunë shumë pak ka hapësira publike në raport me numrin e banorëve si psh në Komunë janë vetëm dy hektar tokë në gjithë terRitorin e Komunës ,poashtu edhe sheshe ka shumë pak vetëm 0.24h sa i takon banorëve po ashtu kërkohet edhe mirëmbajtje, mendimi im është se kjo është një sfidë sa i takon hapësirave publike duhet të punohet edhe të mirëmbahen, por si kërkesa çdo hapësirë e gjelbër që punohet dhe kjo të financohet nga buxheti komunal por varësisht mundësive, poashtu edhe

mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese të kontrollohet nga punëtorët komunal sepse deri më tani nuk ka treguar sukses mirëmbajtja me ofertues.

## Fusha e tetë- Infrastruktura Lokale

Gjatësia e rrugëve të përgjithshme lokale të shtrura ,ky tregues mat performancën komunale me asfaltim apo kubëza në kilometra gjatësi nga gjatësia totale e rrugëve lokale në kilometra ,për këtë tregues duhet të përcaktohen qartë rrugët rajonale edhe kombëtare të cilat kalojnë nëpër territorin e Komunës sonë .

Propozimi i kësaj fushe mendoj që do të ishte mirë dhe i saktë që Drejtoria e Shërbimeve Publike të formojë një databazë të rrugëve që janë të asfaltura edhe që do të asfaltohen në vijim ,ne e dijmë se Zyra e prokurimit ka kontratat por më mirë është që edhe drejtoria ti ketë këto të dhëna si fillimin e kontratës edhe mbarimin e saj ,poashtu kërkohet edhe sa mirëmbahen rrugët që janë të shtruara me trotuare, sa janë të shtrura rrugët në përgjithësi ,sa janë të pajisura me ndriqim rrugët në komunën tonë ,sa janë të shenjëzuara rrugët .

Sa i takon kësaj fushe duhet ti japim rëndësi më shumë të që të mirëmbahen rrugët poashtu edhe ndriqimi është si mangësi dhe duhet ti kemi si prioritet edhe rrugët e reja që ndërtohen dhe varësisht nga terreni të jenë të ndërtuara me trotuare aty ku është mundësia .

Sa i takon infrastrukturës kemi mjaft rrugë të asfaltura por është problem se na mungon një database që ti fusim të dhënat sa rrugë apo trotuare janë ndërtuar, ky tregues kërkohet,kishte qenë mirë që të regjistrohen të gjitha rrugët e asfaltura,kubëzura si në njërën anë poashtu edhe anën tjetër ,sa janë me ndriqim publik sa janë të mirëmbajtura ,sa janë të shenjëzura përveç që zyra e prokurimit i ka .

Për vitin 2018 përqindja e rrugëve lokale të shtrura është 76.6 të mirëmbajtura 70.8 kurse rrugët lokale me trotuare janë 34.2 % kurse rrugët me ndriqim publik me 22.2 % kurse të shenjëzuara 75.5 % është mirë ti japim mundësi aty ku ka përqindje më të vogël të rregullohet nëse kemi mundësi buxhetore.

## Fusha e nëntë- Transporti publik Komunal

Transporti publik duhet të ketë plane të aktiviteteve të punës ,ku në përgjithësi neve na mungon një plan i punës dhe në fund të vitit duhet ta kemi me përqindje se sa është realizuar ai plan,gjithashtu në këtë fushë kërkohet sa vendbanime janë të kyqura me sistem të transportit, këtu është një mangësi e madhe sa i takon shenjëzimit të vendndalimit të autobusëve ,poashtu ka edhe mangësi të vendndalimit të automjeteve taksi ,mungesa kryesore është te shenjëzimi i vendndalimeve të transportit lokal, në Komunë kemi mangësi të kësaj fushe.

## Fusha e dhjetë- Hapësira për parkingje publike

Ka mangësi të parkingjeve në Komunën tonë pothuajse në këtë fushë nuk jemi mirë sa i takon parkingjeve ,nuk ka asnjë parking për personat me aftësi të kufizura kishte qenë mirë që aty ku janë mundësitë të ndërtohet ose rregullohet infrastruktura e përshtatshme.

## Fusha e njëmbëdhjetë - Furnizimi me ujë të pijshëm

Të gjitha të dhënat janë marrë nga Hidrosistemi i Radoniqit ,kishte qenë mirë nëse është e mundur që komuna të ketë një raport tre mujor ,gjashtë mujor edhe vjetor sa i takon furnizmit me ujë të pijes gjithashtu edhe kyqjes së furnizmit ,te ne janë të përfshirë rreth 30 vendbanime me sisitem të ujësjellësit.

## Fusha e dymbëdhjetë- Kanalizimi

Rreth 34 Vendbanime janë të kyqura në sistemin e kanalizimit ,në këtë fushë është mangësi trajtimi i ujërave të zeza ,ndërtimi , zgjerimi dhe mirëmbajtja e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza ,mangësi është se shumica e kanalizimeve derdhen te Drini e Bardhë.

## Fusha e trembëdhjetë -Menagjimi i Mbeturinave

Komuna e ka planin vjetor sa i takon menagjimit të mbeturinave,poashtu edhe sa janë të realizuara nga plani gjithashtu duhet të kemi raport vjetor, sepse plani është pesëvjeçar .

Në Komunën tonë janë 36 vendbanime të kyqura në sistemin e mbeturinave andaj duhet të kërkojmë nga kompanitë përkatëse që mbledhin mbeturinat të bëjnë raport mujor ,tremujor dhe vjetor për mbledhjen dhe menagjimin dhe deponimin e tyre ,problem tjetër është se Komuna jonë ende se ka të rregulluar vendin për mbeturinat për konstruktim edhe demolim sa i takon mbeturinave ,poashtu në bazë të planit duhet të bëhen fushata vetëdijesuese për mbeturina .

Mangësia te kjo fushë është se personat që kanë të bëjnë me inkasimin nuk po i tregojnë kompanitë përkatëse .

## Fusha e katërmbëdhjetë -Mbrojtja e Mjedisit

Te kjo fushë mungon PLANI LOKAL I MJEDSIT ,për shkak të mungesës buxhetore nuk është punuar ky plan andaj kërkojmë që të merret parasysh dhe të punohet ky plan dhe lejet ndërtimore që i marrin palët duhet të inspektohen nga inspektoriati ,mangësi është se për sipërfaqet e dëmtura mjedisore Komuna duhet të planfikojë buxhet që të përmirësohen këto sipërfaqe dhe të kemi sa më shumë gjelbrim dhe mjedis të pastër .

**2.PËRFUNDIM**

Matja e performancës është një instrument i rëndësishëm i të gjitha programeve të menaxhimit të cilësisë. Si institucion, kemi përgjegjësi të dijmë se si, ku, dhe kur duhet t'i marrim masat për ndryshimet e nevojshme në zhvillim të institucionit.

Matja e performancës ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve apo të mendimeve për të kuptuar se si një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të punës ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e punës së pasuksesshme, duke ndihmuar komunën në konfirmimin e arritjeve të synuara në ofrimin cilësor të shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve të saj. Përveç kësaj, ka të bëj me rritjen e optimizmit për punë më efikase dhe më efektive në procesin e ofrimit të shërbimeve cilësore. Këto veprime ndodhin në një cikël të vazhdueshëm, që krijojnë mundësitë për zgjerim dhe përmirësim të procesit të punës në ofrim të shërbimeve sa më cilësore, duke u bazuar në metodologjitë standarde. Qëllimi kryesor është krijimi i bazës relevante profesionale për vendimmarrje praktike dhe strategjike, që ndikojnë në cilësinë e punës së Komunës për të prodhuar shërbime cilësore.

***Komuna e Rahovecit është renditur e katërta me radhë duke pranuar kështu edhe çmimin për performancën më të mirë komunale për vitin 2018.***

Mbetemi të përkushtuar për tu bërë shembull i mirë i qeverisjes lokale në nivel vendi.

***Me respekt!***

Blondina Ramaj- Fazliu

***Rahovec, Maj 2019***

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 1820 Më / Dt. 31.05.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të neneve 12, 17, 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neni 2, neni 10 paragrafi 1 dhe 2, neni 39, 40, 57 dhe 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2019, merr këtë:

# V E N D I M

## Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022

1. **Miratohet** vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022.

2. Shtojcë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2020-2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***U dërgohet:***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I  I  K O M U N Ë S  N Ë R A H O V E C**

**01 Nr. 1820**
**Rahovec, 31.05.2019**

**Afrim Dina**
**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec*

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE ( KAB )
# E KOMUNËS SË RAHOVECIT
# 2020-2022

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2019

# Përmbajtja:

I. Hyrje ..... 2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme ..... 3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes: ..... 4
2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë ..... 4
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim ..... 5
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve ..... 5
5. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale ..... 6
6. Përcaktim i përhershëm i yni janë: ..... 6
7. Rinia, kultura dhe sporti ..... 7
III. Korniza Fiskale Komunale ..... 7
3.1 Indikatorët ekonomik komunal ..... 7
3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2020-2022 ..... 8
3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2020-2022 ..... 12
3.4 Analiza Gjinore ..... 19

## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integrimit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2020/2022-1 të lëshuara nga Ministria e Financave ne pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2020-2022. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

I

Draft KAB - it 2020-2022 — Fillimi i Qershorit

II

Kuvendi Komunal dhe Konsultimet — Mesi i Qershorit

III

Publikimi Dokumentit të KAB-it 2020-2022 Fundi i Qershorit

IV

Procesi vjetor i buxhetit 2020

## II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike që i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra dhe 2 vendbanime dhe një qendër urbane e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 2966 biznese operojnë brenda komunës tonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të komunës dhe 8 të tjera në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2020-2022 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në

Qarkoret Buxhetore Komunale 2020-2022 (I & II) të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Rahovecit është: të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, arsimit dhe jetës sportive. Po ashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy atribute të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

**Këto prioritete janë:**

**1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:**

- Krijimit të zonave ekonomike dhe zona industriale.
- Lehtësira në të bërit biznes, lirim nga taksa e bizneseve për prodhuesit.
- Mbështetje direkte dhe indirekte bizneseve.
- Mbështetja e turizmit dhe agroturizmit.
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes
- Investime në infrastrukturë publike në zona potenciale për zhvillim ekonomik.

**2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë**

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë.

- Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor duke i klasifikuar për secilin sektor si:

  a) Perimekulturë dhe Pemëtari - Mekanizëm bujqësor (kultivator të vegjël, spërkatëse, frezë, pllug, etj.)
  b) Përkrahje me serra me sipërfaqe deri në 3 ari,5 ari, dhe me 10 ari.

- Përkrahje fermerëve me farëra, pleh kimik, pajisje bujqësore dhe me inpute bujqësore
- Sektori i Blegtorisë - përkrahje në makina mjelëse, stalla dhe ferma të vogla
- Sektori i Bletarisë - koshere për bletë, pajisje për trajtim dhe ruajtje të mjaltit etj.
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventar

Një theks i veçantë për këtë sektor do të bie në: këshillime dhe hartim të projekteve për fermerët, në sigurim të tregut për fermerë etj.

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit
- Hapjen e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë si: funksionalizim i tregjeve në Krushë të Madhe, Ratkoc, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e 2 tregjeve të reja në qytetin e Rahovecit, po ashtu vazhdimin e fazës së dytë të projektit "Infrastruktura e tregut të rrushit" - te Shtëpia e Verës
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre

**Prioritetet i kemi edhe në:**

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore,
- Ndërtimin e kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet
- Zgjerimin e sistemit të ujitjes në zonat ku mungon,
- Krijimin e fondit për Emergjencë etj.

Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Toka e cila është nën menaxhim të Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK) do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

## 3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimi i shkollave të reja.
- Eficienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave
- Investime në mjete konkretizimi, laboratorë, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, Këshillave Drejtuese të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimdhënësve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë.

## 4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet,
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta,
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile,
- Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore etj.,
- Krijimi i kushteve më të mira për stafin shëndetësor,
- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak,
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse,

- Parandalimi i sjelljeve të këqija Droga, Duhani dhe Alkooli,
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyre të barabartë,
- Shtimi i personelit shëndetësor,
- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla.

Rehabilitimi i pacienteve me sëmundje mentale dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre.

## 5. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve
- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik, mirëmbajtja dhe numerizimi),
- Krijimi i shesheve të reja, parkingjeve dhe mirëmbajtja e tyre,
- Kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza,
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit,
- Eficienca e energjisë në objekte të sektorit publik,
- Menagjimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre,
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe urbane, hartimi i projekteve të tjera dhe mbikëqyrja e punimeve,
- Përkushtim ndaj komplekseve përkujtimore, shtatoreve, varrezave dhe busteve të dëshmorëve, varrezave të martirëve dhe atyre civile,
- Përmirësimi i standardeve ambientale,
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm,
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre,
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe përrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre,
- Përkushtim ndaj të pastrehëve dhe familjeve në nevojë,
- Mbjellja e më shumë drunjve dekorativ dhe mirëmbajtja,

## 6. Përcaktim i përhershëm i yni janë:

- Qeverisje komunale e cila ofron shërbime efikase dhe që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qasja sa më e afërt dhe e lehtë e qytetarëve në administratë.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile.
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile
- Sistemimi i zyrtarëve të zyrës së pranimit, kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, që kanë për qëllim shkurtimin e kohës për palët
- Rregullimi i sporteleve të veçanta për mërgatën
- Vendosja e E-Kiosk – për shërbimet e shpejta dhe efikase për palë.

### 7. Rinia, kultura dhe sporti

- Mbështetja e sektorit të rinisë dhe kulturës (përkrahja e grupeve dhe OJQ-ve të ndryshme),
- Krijimi i rrjetit të OJQ-ve,
- Funksionalizimi i kuvendit të të rinjve,
- Krijimi i Teatrit të Qytetit,
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë,
- Intervenimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre,
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë,
- Trajtimi i palestrave të sporteve dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive,
- Ngritja dhe mbështetja e të gjitha klubeve sportive etj.

## III. Korniza Fiskale Komunale

### *3.1 Indikatorët ekonomik komunal*

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të përpiluar nga Qeveria e Republikës se Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2020-2022 ku parashihet një rritje reale vjetore, **4.78** % në vitin 2020, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendit në 2020 - 2022 parashihet të jetë 4.81%, respektivisht 5.14%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme ulet me 1.6 %, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grantet qeveritare**. Komunat po ashtu janë pranuese të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2020-2022,nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: *Indikatorët ekonomik komunal*

| Përshkrimi | 2019 | 2020 | 2021 (vlerësimet) | 2022 (vlerësimet) |
|---|---|---|---|---|
| Indikatorët makroekonomik në Kosovë | | | | |
| **Rritja reale e BPV në %** | 4.7 | 4.70 | 4.51 | 4.64 |
| **Inflacioni në %** | **1.7** | **1.40** | **1.31** | **1.31** |
| **BPV për kokë banori, në euro** | **7.123** | **7.520** | **7.946** | **8.389** |
| Indikatorët ekonomik komunal | | | | |
| **Popullsia e Komunës** | **56.208** | **56.208** | **56.208** | **56.208** |
| **Numri i bizneseve të regjistruara** | **2450** | **3684** | **3780** | **3800** |
| **Numri i nxënësve** | **10.841** | **10.312** | **10.312** | **10.312** |

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2020-2022

## *3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2020-2022*

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite (2020 – 2022), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2020 grantet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej 7.08%. Rritje e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 7.08% ne vitin 2020 ne krahasim me 2019, ndërsa në krahasim me vitin 2019 dhe 2022 kemi rritje prej 14.98% sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2020-2022

Të hyrat vetanake komunale, kanë shënuar zvoglim (rrenje) për -1.02% nga viti 2019. Kjo përqindje e zvogëlimit e të hyrave vetanake eshte rrezulltat, se të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut tani e tutje do te planifikohen nga niveli qendror,përkatësisht nga Ministria e Puneve të mbrendshme e jo nga Komunat. Realisht nëse shikojmë planifikimin nga viti 2020 deri në vitin 2022 rritja i të hyrave vetanake të planifikuara do të jetë 14.98%.

**Tabela 2**: *Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2022, në Euro*

| Burimi i të hyrave | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **Totali i buxhetit** | **13.658.895,00** | **14.735.819.00** | **15.254.800.00** | **15.821.730.00** |
| Granti qeveritar | 12.321.510,00 | 13.578.978.00 | 14.006.658.00 | 14.482.246.00 |
| Granti i përgjithshëm | 5.231.296,00 | 5.843.393.00 | 6.166.380.00 | 6.534.106.00 |
| Granti i Shëndetësisë | 1.686.240,00 | 1.889.703.00 | 1.965.291.00 | 2.043.903.00 |
| Granti i Arsimit | 5.380.480,00 | 5.820.978.00 | 5.850.083.00 | 5.879.333.00 |
| Huamarrja në Arsim | 33.719,00 | | | |
| Këshilli i Hoçës së Madhe | 23.494,00 | 24.904.00 | 24.904.00 | 24.904.00 |
| Huamarrja në Shëndetësi | 134.899,00 | | | |
| **Të hyrat vetanake** | **1.168.767,00** | **1.156.841,00** | **1.248.142,00** | **1.339.484,00** |
| **Buxhet dhe Financa** | **425.767,00** | **626.673,00** | **714.303,00** | **802.285,00** |
| Tatimi në Pronë | 310.000,00 | 390.333,00 | 402.043,00 | 414.105,00 |
| Tatimi në Tokë | 78.767,00 | 150.840,00 | 226.260,00 | 301.680,00 |
| Taksa tjera administrative | 2.000,00 | 500,00 | 500,00 | 500,00 |
| Taksat rrugore | 35.000,00 | 85.000,00 | 85.500,00 | 86.000,00 |
| **Administrata** | **84.500,00** | **97.568,00** | **97.650,00** | **98.020,00** |
| Taksa Çertifikatat e lindjes | 45.000,00 | 72.500,00 | 72.500,00 | 72.700,00 |
| Taksa Çertifikatat e kurorëzimit | 14.000,00 | 3.500,00 | 3.550,00 | 3.600,00 |
| Taksa Çertifikatat e vdekjes | 4.500,00 | 1.200,00 | 1.250,00 | 1.300,00 |
| Taksa Çertifikatat tjera ofiqarie | 18.000,00 | 1.168,00 | 1.200,00 | 1.200,00 |
| Taksa tjera administrative | 3.000,00 | 19.000,00 | 19.050,00 | 19.100,00 |
| Takse per pjesemarrje ne tender | - | 200,00 | 100,00 | 120,00 |
| **Ekonomia** | **130.500,00** | **163.600,00** | **163.300,00** | **163.800,00** |
| Licenca te lira individuale | - | 900,00 | 100,00 | 100,00 |
| Licenca tjera per afarzem | - | 100,00 | 100,00 | 100,00 |
| Takse për ushtrimin e veprimtarisë | 75.000,00 | 87.500,00 | 88.000,00 | 88.500,00 |
| Qiraja nga objektet publike | 55.000,00 | 75.000,00 | 75.000,00 | 75.000,00 |
| Taksa tjera administrative | 500,00 | 100,00 | 100,00 | 100,00 |
| **Kulturë, Rini, Sport** | **4.000,00** | **3.800,00** | **3.850,00** | **4.300,00** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shitja e sherbimeve(Bibloteka) | 4.000,00 | 3.800,00 | 3.850,00 | 4.300,00 |
| **Urbanizmi** | **103.000,00** | **22.450,00** | **23.450,00** | **23.800,00** |
| Taksa komunale për leje ndërtimi | 35.000,00 | 200,00 | 200,00 | 200,00 |
| Taksa tjera administrative | 4.000,00 | 4.200,00 | 4.250,00 | 4.300,00 |
| Taksa për demolim | 2.000,00 | 550,00 | 600,00 | 800,00 |
| Taksa për legalizimin e objekteve | 38.000,00 | - | - | - |
| Shfrytëzimin e pronës publike | 24.000,00 | - | - | - |
| Inspektimi respektimi I planit urbanistik | | 17.500,00 | 18.400,00 | 18.500,00 |
| **Kadastër dhe Gjeodezia** | **70.000,00** | **71.250,00** | **71.500,00** | **71.800,00** |
| Taksa për regjistrimin e trashëgimisë | 37.000,00 | 23.250,00 | 23.400,00 | 23.600,00 |
| Taksa tjera administrative | 27.000,00 | 25.000,00 | 25.100,00 | 25.200,00 |
| Taksa për matjen e tokës në terren | 18.000,00 | 23.000,00 | 23.000,00 | 23.000,00 |
| **Shërbime Publike** | **160.800,00** | **63.300,00** | **64.400,00** | **64.934,00** |
| Taksa për leje gërmime | 1.800,00 | | | |
| Taksa tjera administrative | 1.000,00 | 800,00 | 1.500,00 | 1.600,00 |
| Te hyrat nga shitja e mbeturinave | 140.000,00 | 47.000,00 | 47.200,00 | 47.400,00 |
| Shfrytëzimi i pronës publike | 10.000,00 | 12.000,00 | 12.100,00 | 12.234,00 |
| Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare | 8.000,00 | 500,00 | 600,00 | 700,00 |
| Qiraja nga objektet publike | - | 3.000,00 | 3.000,00 | 3.000,00 |
| **Inspekcioni** | **6.000,00** | **2.000,00** | **2.300,00** | **2.550,00** |
| Taksa tjera administrative | 6.000,00 | 1.000,00 | 1.200,00 | 1.400,00 |
| Gjobat nga inspektoriati | - | 1.000,00 | 1.100,00 | 1.150,00 |
| **Bujqësia** | **10.600,00** | **55.300,00** | **56.100,00** | **56.500,00** |
| Taksa tjera administrative | 1.200,00 | 800,00 | 850,00 | 900,00 |
| Taksa -të hyrat nga pyjet | 400,00 | 500,00 | 550,00 | 600,00 |
| Shfrytëzimi i pronës publike(**Qiraja e tokës bujqësore**) | 500,00 | 1.000,00 | 1.500,00 | 1.300,00 |
| Participimet në Bujqësi | 8.500,00 | 52.000,00 | 52.100,00 | 52.500,00 |
| Taksa per nderimin e destinimit te shfrytezimit te tokes | - | 1.000,00 | 1.100,00 | 1.200,00 |
| **Arsimi** | **25.000,00** | **9.900,00** | **10.189,00** | **10.300,00** |
| Participimet -qerdhja e femijeve | 10.000,00 | 9.500,00 | 9.650,00 | 9.700,00 |
| Taksa tjera administrative | - | 200,00 | 289,00 | 300,00 |
| Participim për arsim joformal | 15.000,00 | 200,00 | 250,00 | 300,00 |
| **Shëndetësia** | **50.000,00** | **41.000,00** | **41.100,00** | **41.200,00** |
| Participimi nga shëndetësia | 50.000,00 | 40.000,00 | 40.000,00 | 40.000,00 |
| Taksa tjera administrative | - | 1.000,00 | 1.100,00 | 1.200,00 |
| **Mbrojtje dhe siguri civile** | **98.600,00** | - | - | - |
| Gjobat në trafik | 43.600,00 | - | - | - |
| Gjobat në trafik nëpërmjet gjykatave | 55.000,00 | - | - | - |

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

### 3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorëve e jashtëm dhe te brendshëm do të vazhdoj edhe gjate viti 2020-2022 në shume fusha si në arsim, infrastrukture, menaxhimin e mbeturinave, ujerave të zeza etj.

### 3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të iniciuara në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës

2020-2022, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8%, në vitet e ardhshme. Projeksionet e bëra për 2020 dhe 2022 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj diference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grantin e arsimit, sidomos duhet pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Rahovecit, është edhe politika që do të zgjidhet nga viti 2020 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Rahovecit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin këtij fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave.

Së katerti, Komuna e Rahovecit ka mirëprit deklarimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eleminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal.

Edhe në të ardhme barra kryesore në realizimin e hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin ne tokë.

### *3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2020-2022*

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2020 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2020, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Rahovecit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 do ti paraqesim sipas kategorive ekonomike që aktualisht janë funksionale (figura 2)

| | |
|---|---|
| • Pagat dhe mëditje | 8,540,181.00 € |
| • Mallrat dhe Shërbim | 1,645,776.00 € |
| • Shpenzimet Komunale | 255,500.00 € |
| • Subvencionet dhe Transferet | 250,000.00 € |
| • Shpenzimet Kapitale | 4,044,362.00 € |
| **TOTAL** | **14,735,819.00 €** |

### 3.3.1 Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet 13.3 % si rezultat i ligjit te pagave pagesën e stazhit të punës . Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2020-2022 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 4.7 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rritja me e lartë prej rreth 5.8% në këtë kategori pritet të ndodhë gjatë vitit 2020, si rezultat i implementimit të legjislacionit sekondar që ka të bëjë me reformën në administratën publike, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të rritet ndjeshëm. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **57.96 %.**

### 3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është rrritje për 8.68 % nga viti 2019 në vitin 2020, edhe pse kemi rritje të konsiderueshme te shpenzimeve të kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve **për pagesën e mbeturinave**, për mirëmbajtën e projekteve (të reja) kapitale shkollave, pagesat për ndriçimet publike, shërbimet e varrimit, pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj), rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të

objekteve te reja). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 vite të ardhshme pritet të jetë mesatarisht 10.19 %.

### 3.3.3 Subvencionet

Në vitin 2020 komuna e Rahovecit do te ndaje subvencionet për bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport. Nga viti 2018 shpenzimet për shërbimet e varrimit janë tërhequr nga kjo kategori, por nga kategoria e subvencioneve do të paguhet bursat për studenteve. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2020-2022 mesatarisht do të 1.70%.

### 3.3.4 Investimet Kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë zbritje në vitin 2020, për -3.73% krahasuar me vitin 2019. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja në investimet kapitale, nga buxheti i komunës do të përmirësohet nga viti 2021, mirëpo edhe në vitin 2022 do të jetë më e lartë nga aktualja. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2020 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: 27.457 %.



**Tabela 3**: *Korniza Buxhetore Komunale 2019-2021, në euro.*

| | Përshkrimi | 2018 | 2019 (plani) | 2020 (vlerësimet) | 2021 (vlerësimet) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | TË HYRAT TOTALE KOMUNALE | | | | |
| 1.1 | Të hyrat vetanake | | | | |
| 1.2 | Grantet dhe transferet qeveritare | | | | |
| 2 | SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE | | | | |
| 2.1 | **Shpenzimet rrjedhëse** | | | | |
| | Pagat dhe mëditjet | | | | |
| | Mallrat dhe shërbimet | | | | |
| | Shpenzime komunale | | | | |
| | Subvencionet | | | | |
| 2.2 | **Shpenzimet Kapitale** | | | | |
| | SUFICIT / DEFICIT | | | | |
| | Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale | | | | |
| 3 | BILANCI PRIMAR BUXHETOR | | | | |
| 3.1 | Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm | | | | |
| 4 | BILANCI TOTAL BUXHETOR | | | | |
| 5 | FINANCIMI | | | | |
| 5.1 | **Financimi i jashtëm** | | | | |
| | Ripagimi i borxhit kryesor | | | | |
| | Huamarrja e jashtme | | | | |
| 5.2 | **Financimi i brendshëm** | | | | |
| | Shitja e aseteve | | | | |
| | Huamarrja e brendshme | | | | |
| | Ndryshimi në fitimet e pashpërndara | | | | |
| 6 | BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT | | | | |

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve ne komune në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 7) janë ato aktualet të vitit 2019, planifikimi për vitin e ardhshëm 2020 si dhe projeksionet e vitit 2020-2022 do te behën pas përgatitjes së buxhetit në shtator (Tabela 8-9-10).

**Tabela 4:** *Shpenzimet në vitin 2020, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:*

| Programet | Paga | Mallra dhe shërbime | Shërbime komunale | Subvencione | Investime Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e kryetarit | | | | | | 0 |
| Administrata | | | | | | 0 |
| Barazia gjinore | | | | | | 0 |
| Inspekcioni | | | | | | 0 |
| Zyra e Kuvendit K. | | | | | | 0 |
| Buxhet dhe financa | | | | | | 0 |
| Shërbime publike | | | | | | 0 |
| Zjarrfikësit | | | | | | 0 |
| Zyra për komunitete | | | | | | 0 |
| Bujqësia | | | | | | 0 |
| Ekonomia | | | | | | 0 |
| Kadastra | | | | | | 0 |
| Urbanizmi | | | | | | 0 |
| Shëndetësia | | | | | | 0 |
| QPS | | | | | | 0 |
| Kulturë,Rini, Sport | | | | | | 0 |
| Administrata Arsimit | | | | | | 0 |
| Arsimi parafillor | | | | | | 0 |
| Arsimi fillor | | | | | | 0 |
| Arsimi mesëm | | | | | | 0 |
| **TOTAL** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

**Tabela 5**: *Shpenzimet për 2020, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kuvendit K. | | | | | | 0.00 |
| Buxhet dhe financa | | | | | | 0.00 |
| Shërbime publike | | | | | | 0.00 |
| Zjarrfikësit | | | | | | 0.00 |
| ZLK | | | | | | 0.00 |
| Bujqësia | | | | | | 0.00 |
| Ekonomia | | | | | | 0.00 |
| Kadastra | | | | | | 0.00 |
| Urbanizmi | | | | | | 0.00 |
| Shëndetësia | | | | | | 0.00 |
| QPS | | | | | | 0.00 |
| Kulturë, Rini, Sport | | | | | | 0.00 |
| Administrata e Arsimit | | | | | | 0.00 |
| Arsimi parafillor | | | | | | 0.00 |
| Arsimi fillor | | | | | | 0.00 |
| Arsimi mesëm | | | | | | 0.00 |
| **TOTAL** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | **0.00** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**Tabela 6:** *Shpenzimet , projeksionet 2020, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:*

| Programe | Paga | Mallra dhe shërbime | Shërbime komunale | Subvencione | Investime Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kryetarit | | | | | | 0 |
| Administrata | | | | | | 0 |
| Barazia gjinore | | | | | | 0 |
| Inspekcioni | | | | | | 0 |
| Zyra e Kuvendit K. | | | | | | 0 |
| Buxhet dhe financa | | | | | | 0 |
| Shërbime publike | | | | | | 0 |
| Zjarrfikësit | | | | | | 0 |
| Zyra për Komunitete | | | | | | 0 |
| Bujqësia | | | | | | 0 |
| Ekonomia | | | | | | 0 |
| Kadastra | | | | | | 0 |
| Urbanizmi | | | | | | 0 |
| Shëndetësia | | | | | | 0 |
| QPS | | | | | | 0 |
| Kulturë, Rini, Sport | | | | | | 0 |
| Administrata e Arsimit | | | | | | 0 |
| Arsimi parafillor | | | | | | 0 |
| Arsimi fillor | | | | | | 0 |
| Arsimi i mesëm | | | | | | 0 |
| **TOTAL** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

**Tabela 7:** *Shpenzimet, projeksionet 2021, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:*

| Programe | Paga | Mallra dhe shërbime | Shërbime komunale | Subvencione | Investime Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kryetarit | | | | | | 0 |
| Administrata | | | | | | 0 |
| Barazia gjinore | | | | | | 0 |
| Inspekcioni | | | | | | 0 |
| Zyra e Kuvendit K. | | | | | | 0 |
| Buxhet dhe financa | | | | | | 0 |
| Shërbime publike | | | | | | 0 |
| Zjarrfikësit | | | | | | 0 |
| Zyra për Komunitete | | | | | | 0 |
| Bujqësia | | | | | | 0 |
| Ekonomia | | | | | | 0 |
| Kadastra | | | | | | 0 |
| Urbanizmi | | | | | | 0 |
| Shëndetësia | | | | | | 0 |
| QPS | | | | | | 0 |
| Kulturë, Rini, Sport | | | | | | 0 |
| Administrata e Arsimit | | | | | | 0 |
| Arsimi parafillor | | | | | | 0 |
| Arsimi fillor | | | | | | 0 |
| Arsimi i mesëm | | | | | | 0 |
| **TOTAL** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më lartë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes

përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

## *3.4 Analiza Gjinore*

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të punësuar në kuadër të komunës, dhe i paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Sqarim: Tabela e më poshtme bazohet në shifrat sipas listës së pagave dhe mëditje të qershorit 2018 dhe numrin aktual të të punësuarve.

**Tabela 8:** *Struktura e te punësuarve sipas gjinisë*

| **Programe** | **Struktura e të punësuarve sipas gjinisë – listat e pagave** | | | | | **% STRUKT** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Femra** | **%** | **Meshkuj** | **%** | **Total** | |
| Zyra e Kryetarit | | | | | | |
| Administrata | | | | | | |
| Inspekcioni | | | | | | |
| Zyra e Kuvendit Komunal | | | | | | |
| Buxhet dhe financa | | | | | | |
| Shërbime publike | | | | | | |
| Zjarrfikësit | | | | | | |
| Zyra për Komunitete | | | | | | |
| Bujqësia | | | | | | |
| Ekonomia | | | | | | |
| Kadastra | | | | | | |
| Urbanizmi | | | | | | |
| Kulturë, Rini, Sport | | | | | | |
| Arsimi dhe shkenca | | | | | | |
| Shëndetësia | | | | | | |
| QPS | | | | | | |

**Tabela 9:** *Struktura gjinore e të punësuarve në Arsim*

| Struktura gjinore e të punësuarave në Arsim sipas listës së pagave Qershor-2017 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Të punësuar | **Meshkuj** | **%** | **Femra** | **%** | **Total** |
| DKA | | | | | |
| Drejtorë/esha | | | | | |
| Zv. drejtorë/esha | | | | | |
| Sekretarë/esha | | | | | |
| Profesorë/esha | | | | | |
| Arsimtarë/e | | | | | |
| Edukator/e | | | | | |
| Punëtor ndihmës/e | | | | | |
| Klasa speciale | | | | | |
| Bibliotekë | | | | | |
| **Total** | | | | | |

**Tabela 10:** *Struktura gjinore e të punësuarve në Shëndetësi*

| Struktura gjinore e të punësuarve në Shëndetësi sipas listës së pagave - Qershor 2017 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Të punësuar** | **Meshkuj** | **%** | **Femrave** | **%** | **Total:** |
| Drejtorë | | | | | |
| Mjekë | | | | | |
| Teknikë | | | | | |
| Të tjerë | | | | | |

Komuna do ti përdor më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor në paga dhe mëditje në buxhetet e vitit 2018 për të përgatitur buxhetin në të ardhmen duke respektuar buxhetin e përgjithshëm gjinor. Tek investime kapitale, kur një projekt është për një qytet të caktuar apo të një fshatit, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj. ne do te përdorim të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne do të përdorim numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

Kryesuesi i Kuvendit

Afrim Dina

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01 | Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 777
Nr. i faqeve / Broj strana / No. pages: 4 | Data / Datum / Date: 15.05.2019
PRISHTINË

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
***Qeveria –Vlada-Government***
*Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance*

***Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister***

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.05.2019 |
| PËR/ZA/TO: | Ministrat, Kryetarët e Komunave, Udhëheqësit e Organizatave Buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar, Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore |
| NGA/OD/FROM: | Bedri Hamza, Ministër i Financave |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Qarkorja Buxhetore 2020/01 |

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2020-2022, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2020.

Keni të bashkangjitur Qarkoren Buxhetore 2020/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror për vitin 2020. Ministria e Financave mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të projektligjit të buxhetit për vitin 2020.

Me respekt

Bedri Hamza
Ministër i Financave

Qarkorja Buxhetore 2020/01

## 1. Qëllimi

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2020/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022 për çdo Organizatë Buxhetore. Në rast nevoje, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkore të tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022.

## 2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2020-2022

Korniza për buxhetin e vitit 2020 bazohet në KASH 2020-2022 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2020-2022. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2020-2022, sipas prioriteteve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Projeksionet fiskale të KASH 2020-2022 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2020, dhe vlerësimet e viteve vijuese. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2020/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negocim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

## 3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2019

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2020, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave një parashikim të realizimit deri në fundvit të buxhetit të vitit 2019 në nivel të programeve, nën-programeve, dhe projekteve individuale. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave për nën apo mbi shpenzimet eventuale në buxhetin ekzistues, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2020, dhe vlerësimeve për 2021-2022.

## 4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2020-2022

Procesi buxhetor për vitet 2020-2022 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet të Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2020-2022. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2020-2022. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2020-2022 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2019-2021
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale,
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA),
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues,
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale,
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale si dhe,
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2020 dhe projeksionet për vitet 2021-2022.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë që lidhen me rritjen e qëndrueshme ekonomike, punësimit dhe mirëqenies, sundimit te ligjit, arsimit, shëndetësise dhe integrimeve evropiane.

**Shpenzimet rrjedhëse:** organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcën 1. të bashkangjitur, për vitet 2020-2022. Shpenzimet operative për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim

me vitin 2019. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me përmirësimin e klasifikimit të shpenzimeve nga vitet e kaluara

**Punësimi:** Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për nevojën e punësimeve të reja. Punësimet e reja mbi atë aktual do të bëhen vetën në rastet e domosdoshme.

***Pagat dhe mëditjet:*** Qarkorja buxhetore përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Kjo është për arsye se siç jeni të informuar kohë më parë në Kuvend janë miratuar pakot e ligjeve të Reformës së Administratës Publike, mirëpo aktet nën-ligjore ende nuk janë miratuar, në këtë drejtim Komisionet përkatëse janë duke punuar në përcaktimin e koeficienteve për të gjitha pozitat dhe me qarkoret pasuese do të njoftoheni lidhur me kufirin në paga.

***Mallra dhe shërbime***: kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një mesatare prej 2.2% në periudhën afatmesme. Rritja më e lartë parashihet në vitin 2020, si rrjedhojë e ri klasifikimit prej shpenzimeve kapitale në këtë kategori. Riklasifikimi përfshin si psh.: a) mirëmbajtjen e pajisjeve medicinale; b) mirëmbajtjen e komplekseve memoriale; c) pajisjet për policinë e Kosovës, mirëmbajtja e rrugëve, parqeve etj. Efekti i këtij riklasifikimi vlerësohet se është rreth 14 mil euro gjatë vitit 2020. Pjesa e pa trajtuar e këtij riklasifikimi do të trajtohet në vitin vijues. Përkundër këtyre ndryshimeve, shpenzimet për mallra dhe shërbime pritet të jenë mesatarisht 4.5% në raport me BPV, raport i cili është i ngjashëm me vitet paraprake.

***Shpenzimet komunale:*** priten të ketë pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2019.

***Subvencionet dhe transferet:*** Pas rritjes së shpenzimeve gjatë vitit 2019 si rezultat i mbulimit të kostos së rritjes së pensioneve në disa kategori, dhe rritjes së numrit të përfituesve në skemat tjera, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet mesatarisht për 2.2% në periudhën afatmesme. Rritja më e lartë është paraparë në vitin 2020 kryesisht si rezultat i: pagesës së specializantëve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, ligjit për arsimtarët, ri klasifikimit të transfereve për Ndërmarrjet Publike nga shpenzimet kapitale, fondit të garantimit të kredive, rialokimit të disa shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve kapitale në këtë kategori. Shpenzimet në këtë kategori pritet të jenë 8.4% në raport me BPV-së në vitin 2020 duke vazhduar me trend rënës gjatë viteve 2021 dhe 2022 me pjesëmarrje prej 8.0% dhe 7.6%.

***Shpenzimet kapitale:***

Përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 32.4% të shpenzimeve totale apo një mesatare prej rreth 10.6% të BPV-së për periudhën 2020-2022. Gjatë periudhës afatmesme, pritet të implementohen projektet kapitale bazuar në një listë prioriteteve që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet me një normë prej 2.4% në periudhën afatmesme. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të financohet nga buxheti i rregullt, mirëpo një

numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm si dhe mjetet nga procesi i likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në vazhdim si dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Qeverisë. Të gjitha projektet kapitale mbi një milion euro duhet të përgatiten mbi bazën e analizës **kost-benefit**. Rrjedhimisht, kufijtë buxhetor për shpenzime kapitale nëpër organizata buxhetore janë indikativ dhe Qeveria mban të drejtën t'i ndryshojë ata varësisht nga arsyeshmëria e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.
Pjesa për Ministrinë e Infrastrukturës (MI), Fondet për MI do të rriten varësisht nga ecuria e negociatave për implementimin e projekteve me mekanizmin e Klauzolës së Investimeve e në veçanti projekti Qarkorja e Prishtinës

## 5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në "Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2020-2022" në kuadër të KASH-it 2020-2022 të jenë bazë për përgatiten e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.
Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë kërkesat buxhetore për projektet e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e PIP-it.

## 6. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)

Siç është e njohur, Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë të shpenzimeve. Që tani Sistemi SZHMB është në dispozicion për shfrytëzim nga organizatat buxhetore. Organizatat Buxhetore janë të detyruara që të respektojnë kufijtë e lëshuar me Qarkoren e parë buxhetore. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e parë buxhetore.

## 7. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Organizatat buxhetore duhet të paraqesin 1 deri në 5 objektiva, të cilat janë të lidhura me strategjitë dhe mbulojnë programet më të rëndësishme. Gjithashtu kërkesat për fonde shtesë nga buxheti duhet të justifikohen në mënyrën se si ato kontribuojnë në arritjen e objektivave.
Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 2. Në mënyrë specifike për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen këto informata:

- **Objektivat e outputit** përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore;
- **Treguesit e outputit** matin aktivitetin e institucionit, si p.sh sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit.
  a) Indikatori treguesi bazë;
  b) Indikatori treguesi i synuar;
- Aktivitetet përshkruajnë veprimet për arritjen e objektivave të deklaruara.

## 8. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2020. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunat duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2020-2022. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 1.

## 9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2020-2022

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2020 dhe për dy vitet në vijim. Të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për organizatat buxhetore përkatës, duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2020-2022.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2020-2022

## 10. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2019 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2019.

- 26 Prill – aprovimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2020-2022 nga Qeveria dhe dorëzimi i KASH-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- 15 Maj - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2020/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
- 25 Qershor- Organizatat buxhetore të dorëzojnë në MF kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotht të asyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-se dhe PIP-it.
- 25 Qershor- Departamenti i makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.
- 10 Korrik - Qarkorja buxhetore 2020/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- 25 Korrik- Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrine e Financave – Departamentin e buxhetit deri në këtë datë.
- 26 Gusht – 30 Gusht - Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MF, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Orari i dëgjimeve buxhetore do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2020/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2020.
- 10 Shtator, Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2020-2022.
- 16 Shtator – 20 Shtator, konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetore.
- 25 Shtator, nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor.
- 1 Tetor–4 Tetor Ankesat nga Organizatat Buxhetore.
- 7 Tetor – 8 Tetor, Takimet e Qeverise për t'i shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore.
- 15 Tetor, Drafti i parë i buxhetit në MF dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.
- 16 Tetor –25 Tetor - miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.
- 29 tetor - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2020 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë:

- Një tabelë me parashikimet deri në fundvit të implementimin të buxhetit 2019, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin e apo nevojën për mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2019
- Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së,
- Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor
- Tabelat e Buxhetimit sipas performancës

- Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencise me të gjitha materialet buxhetore.
- Përshkrimi i kërkesës në formë narrative, ku duhet të paraqiten këto të dhëna:
  - Të arriturat deri më tani me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të parapara në SKZH, PRE, PKZMSA
  - Çfarë synohet të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022.
  - Organizatat buxhetore duhet të njoftojnë Ministrinë e Financave nëse kërkesa buxhetore mbulon vazhdimin e politikave ekzistuese, apo parasheh përfundimin e aktiviteteve vijuese dhe fillimin e aktiviteteve të reja
  - Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të theksojne bazën ligjore (koncept dokument, udhëzim administrativ, projektligj, etj.), dhe të njoftojnë nëse për këtë bazë ligjore është kryer Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.

## II. Buxheti Komunal 2020-2022

Me këtë Qarkore përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020 dhe orientimet për vitet 2021-2022, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, kjo Qarkore përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2020 si dhe parashikimin afatmesëm 2021-2022.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komisioni i Granteve në takimin e mbajtur me date 23.04.2019 ka aprovuar financimin komunal për vitin 2020 dhe projeksionet për vitin 2021-2022.

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2020-2022, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal deri me datë 30.06.2019 si dokument strategjik komunal, i cili dokument pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

### 1. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitin 2021-2022

#### *1.1. Granti i Përgjithshëm*

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2020 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 196.3 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet e Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2020 pritet të jenë 2,060.5 milion euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2020 është në shumë prej 196.3 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2020-2022 (mil. Euro)

| Përshkrimi | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë | 1,896.00 | 1,920.3 | 2,060.5 | 2,171.9 | 2,298.3 |
| Zbriten: | | | | | |
| Të hyrat e dedikuara | -50 | -9.2 | | | |
| Mbeshtetja buxhetore dhe grante | -5 | -5 | -11 | -11 | -11 |
| Tatimi në pronë | -30 | -30 | -33 | -37 | -41 |
| Të hyrat nga dividenda | -5 | | | | |
| Grantet e percaktuara të donatorëve | -12 | | | | |
| Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale | -52 | -57 | -50 | -50 | -50 |
| Të hyrat e njëhershme nga borxhet | -6 | -8 | | | |
| Të hyrat nga interesi | | -4.2 | -4 | -4 | -3 |
| B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna | 1,736 | 1,806.9 | 1,962.8 | 2,070.9 | 2,193.9 |
| C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%) | 173.60 | 180.69 | 196.28 | 207.09 | 219.39 |

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2020-2022 sipas LFPL (mil. Euro)

| Faktorët | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| Granti i përgjithshëm | 173.6 | 180.69 | 196.28 | 207.09 | 219.39 |
| Kontigjenca për korrektim të formulës (2.7%) | 4.7 | 4.9 | | | |
| Shuma Fikse | 3.6 | 3.6 | 3.6 | 3.6 | 3.6 |
| Popullsia (banorë) | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 |
| Buxheti: 89% e shumës agregate | 147.1 | 153.3 | 171.5 | 181.1 | 192.0 |
| Zona komunale (km2) | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 |
| Buxheti: 6% e shumës agregate | 9.92 | 10.33 | 11.56 | 12.21 | 12.95 |
| Komunitetet pakicë në komunë | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 |
| Buxheti: 3% e shumës agregate | 5.0 | 5.2 | 5.8 | 6.1 | 6.5 |
| Popullsia e komunave pakicë | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 |
| Buxhti: 2% e shumës agregate | 3.3 | 3.4 | 3.9 | 4.1 | 4.3 |

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna duhet të financohet nga granti i përgjithshëm komunal.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.
Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim para universitar dhe shëndetësi primare kur është e nevojshme.

### 1.2. Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, neni 19 Kryeqyteti i Republikës së Kosovës Prishtina përfiton një grant shtesë nga niveli qendror, në lartësi jo më pak se 6% e grantit të përgjithshëm.
Për vitin 2020 Kryeqyteti, Prishtina përfiton grant shtesë në shumë prej 11,777,096 euro, ndërsa për vitin 2021 përfiton 12,425,296 euro dhe për vitin 2022 përfiton 13,163,280 euro.

Tabela 4: Shpërndarja e Grantit shtesë për financimin e Kryeqytetit 2020-2022

| Përshkrimi | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| Granti i përgjithshëm për komuna | 173.6 | 180.69 | 196.28 | 207.09 | 219.39 |
| Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit (6%) | | 10.84 | 11.78 | 12.43 | 13.16 |

### 1.3. Granti specifik për Arsim parauniversitar

Grantin specifik për arsim parauniversitar për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 205.5 milion euro, nga të cilat 192.1 milion euro janë paga dhe mëditje, 10.8 milion euro janë mallra dhe shërbime dhe 2.5 milion euro shpenzime kapitale. Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2020.
Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2018/2019;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
j) Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehoni është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës);
k) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
l) Shërbimi profesional;
m) Koordinatorët e cilësisë;

n) Kalkulimi i pagave është bazuar në Ligjin e Pagave;
o) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
p) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
q) Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.4 milion euro;
r) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;

Sipas MASHT është raportuar numri për 11,938 nxënës më pak në arsim parauniversitar krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit dhe duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT kërkon nga komunat se me rastin e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të plotë.

## 1.4. Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 61.7 milion euro, nga të cilat 53.4 milion euro janë grant bazë sipas kriterit për kokë banori dhe 8.3 milion euro kosto shtesë për paga dhe mëditje. Shpërndarja e grantit specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2020 është përgatitur sipas kriterit për kokë banori dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal.

Tabela 6: Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2020-2022

| Nr. | Komuna | Demografia | | | | | | | Granti Specifik për Shëndetësi primare për vitin 2020 | Granti Specifik për Shëndetësi primare për vitin 2021 | Granti Specifik për Shëndetësi primare për vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Popullsia | Gjinia | | | Mosha | | Numri i personave me nevoja të veçanta | | | |
| | | | M | F | Femra të moshës riprodhuese 15-49 vjeç | Numri i fëmijëve 0-14 vjeç | Numri i personave të moshuar - mbi 65 vjeç | | | | |
| 1 | Deçan | 40,019 | 20,125 | 19,894 | 10,941 | 10,471 | 4,084 | 151 | 1,361,644 | 1,405,606 | 1,461,831 |
| 2 | Dragash | 33,997 | 17,035 | 16,962 | 8,500 | 10,000 | 5,000 | 497 | 1,117,392 | 1,162,087 | 1,208,571 |
| 3 | Ferizaj | 108,610 | 54,841 | 53,769 | 29,300 | 31,566 | 6,900 | 982 | 3,723,867 | 3,872,822 | 4,027,735 |
| 4 | Fushë Kosovë | 34,827 | 17,621 | 17,206 | 14,123 | 6,585 | 3,202 | 233 | 1,199,054 | 1,247,017 | 1,296,897 |
| 5 | Gjakovë | 94,556 | 47,226 | 47,330 | 25,198 | 25,300 | 9,329 | 1,090 | 3,489,702 | 3,629,290 | 3,774,462 |
| 6 | Gjilan | 90,178 | 45,354 | 44,824 | 24,539 | 23,464 | 6,554 | 180 | 3,036,082 | 3,157,525 | 3,283,826 |
| 7 | Gllogovc | 58,531 | 29,733 | 28,799 | 15,996 | 17,507 | 3,336 | 177 | 1,964,270 | 2,032,441 | 2,113,738 |
| 8 | Hani i Elezit | 9,403 | 4,836 | 4,567 | 1,824 | 2,778 | 560 | 84 | 311,844 | 324,318 | 337,291 |
| 9 | Istog | 39,289 | 19,679 | 19,610 | 10,607 | 10,804 | 2,976 | 486 | 1,362,667 | 1,417,060 | 1,473,742 |
| 10 | Junik | 6,084 | 2,995 | 3,089 | 2,020 | 1,681 | 450 | 50 | 246,286 | 255,097 | 265,301 |
| 11 | Kaçanik | 33,409 | 16,970 | 16,439 | 9,054 | 9,683 | 1,940 | 200 | 1,123,930 | 1,168,887 | 1,215,643 |
| 12 | Kamenicë | 36,085 | 18,559 | 17,526 | 23,263 | 5,389 | 4,140 | 242 | 1,150,672 | 1,196,698 | 1,244,566 |
| 13 | Klinë | 38,496 | 18,960 | 19,537 | 10,726 | 10,915 | 2,830 | 260 | 1,340,163 | 1,393,769 | 1,449,520 |
| 14 | Leposavic | 13,773 | 6,969 | 6,804 | 3,443 | 2,754 | 965 | | 516,494 | 537,154 | 558,640 |
| 15 | Lipjan | 57,605 | 29,325 | 28,280 | 15,355 | 17,461 | 7,032 | 706 | 2,104,564 | 2,188,746 | 2,276,296 |
| 16 | Malishevë | 54,613 | 25,901 | 28,713 | 37,276 | 20,758 | 3,500 | 640 | 1,784,404 | 1,855,780 | 1,930,011 |
| 17 | Mamushë | 5,507 | 2,672 | 2,836 | 2,543 | 2,670 | 737 | 40 | 185,360 | 192,774 | 200,485 |
| 18 | Mitrovicë | 71,909 | 36,275 | 35,634 | 18,624 | 20,351 | 5,074 | 1,200 | 2,436,697 | 2,534,165 | 2,635,531 |
| 19 | Novobërdë | 6,729 | 3,466 | 3,264 | 1,726 | 1,643 | 732 | 41 | 247,951 | 257,869 | 268,184 |
| 20 | Obiliq | 21,549 | 10,885 | 10,664 | 5,636 | 6,419 | 1,239 | 340 | 817,798 | 850,510 | 884,530 |
| 21 | Pejë | 96,450 | 50,466 | 45,985 | 24,817 | 24,993 | 7,495 | 1,411 | 3,439,186 | 3,576,754 | 3,719,824 |
| 22 | Podujevë | 88,499 | 44,955 | 43,544 | 24,042 | 12,975 | 2,476 | 872 | 2,938,671 | 3,056,217 | 3,178,466 |
| 23 | Prishtinë | 198,897 | 99,355 | 99,543 | 55,375 | 51,884 | 13,231 | 1,600 | 7,527,953 | 7,829,071 | 8,142,234 |
| 24 | Prizren | 177,781 | 89,173 | 88,608 | 49,156 | 49,661 | 11,524 | 1,578 | 5,951,383 | 6,189,439 | 6,437,016 |
| 25 | Rahovec | 56,208 | 28,512 | 27,696 | 15,393 | 16,081 | 3,352 | 377 | 1,889,703 | 1,965,291 | 2,043,903 |
| 26 | Shtërpcë | 6,949 | 3,554 | 3,395 | 1,744 | 1,577 | 500 | 47 | 233,353 | 242,687 | 252,394 |
| 27 | Shtime | 27,324 | 13,850 | 13,474 | 5,874 | 7,877 | 1,800 | 253 | 893,463 | 929,202 | 966,370 |
| 28 | Skenderaj | 50,858 | 25,646 | 25,212 | 15,665 | 14,265 | 4,241 | 1,523 | 1,738,586 | 1,808,129 | 1,880,455 |
| 29 | Suharekë | 59,722 | 29,478 | 30,244 | 16,413 | 17,409 | 4,104 | 400 | 1,947,036 | 2,024,916 | 2,105,913 |
| 30 | Viti | 46,987 | 23,686 | 23,301 | 12,343 | 14,168 | 6,100 | 731 | 1,581,704 | 1,644,972 | 1,710,771 |
| 31 | Vushtrri | 69,870 | 36,004 | 33,866 | 18,146 | 19,634 | 4,508 | 750 | 2,345,275 | 2,439,086 | 2,536,650 |
| 32 | Zubin Potok | 6,616 | 3,408 | 3,208 | 1,456 | 1,588 | 476 | 38 | 205,279 | 213,490 | 222,029 |
| 33 | Zveçan | 7,481 | 3,661 | 3,821 | 1,623 | 1,770 | 531 | 18 | 273,206 | 284,134 | 295,500 |
| 34 | Graçanicë | 10,675 | 5,428 | 5,248 | 2,463 | 2,661 | 993 | 81 | 451,874 | 469,949 | 488,747 |
| 35 | Kllokot | 2,556 | 1,417 | 1,140 | 688 | 670 | 214 | 18 | 92,578 | 96,282 | 100,133 |
| 36 | Mitrovica Veriore | 12,326 | 6272.5 | 6053.5 | 2,686 | 2,931 | 879 | 82 | 386,186 | 401,633 | 417,699 |
| 37 | Partesh | 1,787 | 922 | 865 | 477 | 340 | 202 | 0 | 62,520 | 65,021 | 67,622 |
| 38 | Ranillug | 3,866 | 1,969 | 1,897 | 1,012 | 393 | 259 | 0 | 230,926 | 240,163 | 249,769 |
| Total | | 1,780,021 | 897,179 | 882,843 | 520,067 | 479,076 | 133,466 | 17,378 | 61,688,512 | 64,156,052 | 66,722,294 |

### 1.5. Financimi për Shëndetësi sekondare

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 2,603,077 euro sipas propozimit nga MSH dhe projeksioneve të KASH për tri komunat minoritare, si vijon:

- Komuna e Shtërpcës, në shumë prej 522,371 euro,
- Komuna e Mitrovicës së veriut, në shumë prej 989,935 euro, dhe
- Komuna e Graçanicës, në shumë prej 1,090,771 euro.

### 1.6. Financimi për Shërbimet rezidenciale

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 2,040,000 euro.
Për vitin 2020 në kuadër të këtij propozimi është paraparë rritja e stafit prej 22 dhe financimi shtesë për funksionalizimin e Shërbimeve Rezidenciale për personat e moshuar në Komunën e Novobërdës dhe funksionalizimi i shërbimeve rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prizrenit.

Tabela 7: Financimi për shërbime rezidenciale për vitin 2020

| Komunat | Stafi Shtesë | Paga dhe Meditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Shpenzimet Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Skenderaj SHKPM | 0 | 85,000 | 67,000 | 8,000 | 20,000 | 180,000 |
| Graqanice SHKPM/SHKPAK | 0 | 166,000 | 120,000 | 14,000 | 20,000 | 320,000 |
| Istog SHKPM | 0 | 85,000 | 67,000 | 8,000 | 20,000 | 180,000 |
| Deqan SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Ferizaj SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Kamenice SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Vushtrri SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Shtime SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Lipjan SHKPAK | 0 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Prizren SHKPAK | 11 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| Novobërd SHKPM | 11 | 83,000 | 60,000 | 7,000 | 20,000 | 170,000 |
| **Total** | **22** | **1,000,000** | **734,000** | **86,000** | **220,000** | **2,040,000** |

### 1.7. Financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore të fshatit Zym dhe Keshillin e Hoçës së madhe

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjit Nr.04/L-196 për Qendrën Kulturore Historike të Fshatit Zym dhe Ligjit Nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe, me planifikimin e buxhetit për vitin 2020 ndahen mjete financiare në shumë prej 69,048 euro, për dy komunat si vijon:

- Komuna e Prizrenit, në shumë prej 44,144 euro, dhe
- Komuna e Rahovecit, në shumë prej 24,904 euro.

## 1.8. Financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, neni 9 Obiliqi përfiton nga inkasimi i rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës së Obiliqit, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësia biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.
Për vitin 2020 Komuna e Obiliqit bazuar në inkasimin e rentës minerale përfiton financim shtesë prej 4,175,567 euro.

## 1.9. Financimi për Teatro

Financimi për teatro për vitin 2020 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 900,000 euro dhe stafi shtesë prej 124 sipas tabelës së bashkangjitur në vijim.

Tabela 8: Financimi për Teatro për vitin 2020

| Komunat | Stafi | Paga dhe Meditje | Subvencione dhe Transfere | Total |
|---|---|---|---|---|
| Teatri Profesionist Gjilan | 19 | 100,886 | | 100,886 |
| Teatri Profesionist Gjakovë | 14 | 73,443 | 42,500 | 115,943 |
| Teatri Profesionist Prizren | 21 | 111,558 | 29,750 | 141,308 |
| Teatri Profesionist Pejë | 16 | 85,639 | 43,500 | 129,139 |
| Teatri Profesionist Ferizaj | 18 | 94,788 | 18,700 | 113,488 |
| Teatri Profesionist Mitrovicë | 19 | 100,886 | 68,500 | 169,386 |
| Teatri Profesionist Prishtinë-Dodona | 5 | | | - |
| Teatri Profesionist Podujevë | 12 | 79,800 | 50,050 | 129,850 |
| **Totali** | **124** | **647,000** | **253,000** | **900,000** |

## 1.10. Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2020 dhe parashikimet 2021-2022

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2020 janë aprovuar në shumë prej 83.1 milion euro, këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Në këto projeksione janë marr parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme (tatimi në tokë dhe tatimi në pronë) sipas faturimit të tatimit në pronë dhe trendit të realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tri viteve të fundit, duke përjashtuar nga këto projeksione të hyrat nga gjobat në trafik dhe të hyrat nga gjykatat.

Krahasuar me vitin paraprak projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2020 janë me të ulëta për arsyeje se planifikimi i të hyrave nga gjykatat dhe dënimet në trafik tani e tutje do të planifikohen në nivelin qendror (institucionet të cilat i realizojnë këto të hyra).

Tabela 9: Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2020-2022

| Nr. | Komuna | Të hyrat tatimore | | | | | | Të hyrat jo tatimore | | | Projeksionet për vitin 2020 | Projeksionet për vitin 2021 | Projeksionet për vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Tatimi në pronë 2020 | Tatimi në pronë 2021 | Tatimi në pronë 2022 | Tatimi në tokë 2020 | Tatimi në tokë 2021 | Tatimi në tokë 2022 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | | | |
| 1 | Deçan | 231,131 | 238,065 | 245,207 | 168,674 | 253,011 | 337,347 | 370,461 | 372,971 | 375,297 | 770,266 | 864,047 | 957,851 |
| 2 | Dragash | 189,723 | 195,415 | 201,278 | 68,417 | 102,626 | 136,835 | 204,203 | 205,587 | 206,869 | 462,344 | 503,628 | 544,981 |
| 3 | Ferizaj | 2,046,768 | 2,108,171 | 2,171,416 | 605,170 | 907,755 | 1,210,339 | 2,363,589 | 2,379,602 | 2,394,441 | 5,015,526 | 5,395,528 | 5,776,196 |
| 4 | Fushë Kosovë | 889,907 | 916,604 | 944,103 | 62,196 | 93,295 | 124,393 | 1,857,406 | 1,869,991 | 1,881,651 | 2,809,510 | 2,879,890 | 2,950,147 |
| 5 | Gjakovë | 1,612,782 | 1,661,166 | 1,711,001 | 471,803 | 707,704 | 943,605 | 1,637,782 | 1,648,878 | 1,659,160 | 3,722,367 | 4,017,748 | 4,313,766 |
| 6 | Gjilan | 1,609,193 | 1,657,469 | 1,707,193 | 426,368 | 639,551 | 852,735 | 2,363,836 | 2,379,851 | 2,394,691 | 4,399,396 | 4,676,871 | 4,954,619 |
| 7 | Gllogoc | 482,710 | 497,192 | 512,107 | 72,237 | 108,355 | 144,473 | 835,843 | 841,506 | 846,754 | 1,390,790 | 1,447,053 | 1,503,334 |
| 8 | Hani i Elezit | 94,694 | 97,535 | 100,461 | 54,096 | 81,144 | 108,192 | 169,075 | 170,220 | 171,282 | 317,865 | 348,899 | 379,935 |
| 9 | Istog | 348,287 | 358,735 | 369,498 | 146,882 | 220,323 | 293,764 | 656,129 | 660,574 | 664,693 | 1,151,298 | 1,239,633 | 1,327,955 |
| 10 | Junik | 59,082 | 60,854 | 62,680 | 12,274 | 18,412 | 24,549 | 65,843 | 66,289 | 66,703 | 137,199 | 145,555 | 153,931 |
| 11 | Kaçanik | 264,960 | 272,909 | 281,096 | 97,925 | 146,887 | 195,850 | 347,842 | 350,199 | 352,382 | 710,727 | 769,995 | 829,328 |
| 12 | Kamenicë | 277,730 | 286,062 | 294,643 | 101,134 | 151,701 | 202,268 | 483,210 | 486,484 | 489,518 | 862,074 | 924,247 | 986,430 |
| 13 | Klinë | 352,114 | 362,677 | 373,558 | 77,621 | 116,432 | 155,242 | 485,339 | 488,627 | 491,674 | 915,074 | 967,736 | 1,020,474 |
| 14 | Leposaviq | - | - | - | - | - | - | 40,000 | 45,000 | 50,000 | 40,000 | 45,000 | 50,000 |
| 15 | Lipjan | 966,897 | 995,904 | 1,025,781 | 74,490 | 111,735 | 148,980 | 1,039,531 | 1,046,574 | 1,053,101 | 2,080,919 | 2,154,214 | 2,227,862 |
| 16 | Malishevë | 287,742 | 296,374 | 305,265 | 157,129 | 235,694 | 314,259 | 451,220 | 454,277 | 457,109 | 896,090 | 986,344 | 1,076,633 |
| 17 | Mamusha | 26,913 | 27,720 | 28,552 | 5,777 | 8,666 | 11,554 | 30,508 | 30,714 | 30,906 | 63,197 | 67,100 | 71,011 |
| 18 | Mitrovicë | 824,329 | 849,059 | 874,531 | 153,059 | 229,589 | 306,118 | 1,522,587 | 1,532,902 | 1,542,461 | 2,499,975 | 2,611,550 | 2,723,110 |
| 19 | Novobërdë | 81,743 | 84,195 | 86,721 | 29,807 | 44,710 | 59,614 | 130,930 | 131,817 | 132,639 | 242,479 | 260,722 | 278,973 |
| 20 | Obiliq | 402,110 | 414,173 | 426,598 | 49,289 | 73,934 | 98,578 | 571,266 | 575,137 | 578,723 | 1,022,665 | 1,063,244 | 1,103,900 |
| 21 | Pejë | 1,959,535 | 2,018,321 | 2,078,870 | 422,217 | 633,326 | 844,435 | 1,967,843 | 1,981,176 | 1,993,530 | 4,349,595 | 4,632,823 | 4,916,835 |
| 22 | Podujevë | 370,959 | 382,088 | 393,551 | 137,654 | 206,482 | 275,309 | 907,948 | 914,099 | 919,800 | 1,416,561 | 1,502,669 | 1,588,659 |
| 23 | Prishtinë | 8,260,640 | 8,508,459 | 8,763,713 | 879,031 | 1,318,547 | 1,758,063 | 20,118,696 | 20,255,003 | 20,381,309 | 29,258,367 | 30,082,009 | 30,903,085 |
| 24 | Prizren | 2,374,871 | 2,446,117 | 2,519,500 | 474,039 | 711,058 | 948,077 | 4,711,386 | 4,743,306 | 4,772,884 | 7,560,295 | 7,900,481 | 8,240,462 |
| 25 | Rahovec | 390,333 | 402,043 | 414,105 | 150,840 | 226,260 | 301,680 | 615,668 | 619,839 | 623,704 | 1,156,841 | 1,248,142 | 1,339,489 |
| 26 | Shtërpcë | 273,566 | 281,773 | 290,226 | 63,615 | 95,422 | 127,229 | 152,024 | 153,054 | 154,008 | 489,205 | 530,249 | 571,464 |
| 27 | Shtime | 143,994 | 148,314 | 152,764 | 135,579 | 203,368 | 271,158 | 350,077 | 352,449 | 354,647 | 629,651 | 704,132 | 778,568 |
| 28 | Skenderaj | 191,178 | 196,913 | 202,821 | 63,390 | 95,085 | 126,779 | 1,273,446 | 1,282,074 | 1,290,069 | 1,528,014 | 1,574,072 | 1,619,669 |
| 29 | Suharekë | 743,925 | 766,243 | 789,230 | 179,304 | 268,957 | 358,609 | 1,047,427 | 1,054,523 | 1,061,099 | 1,970,656 | 2,089,723 | 2,208,938 |
| 30 | Viti | 388,083 | 399,725 | 411,717 | 102,991 | 154,486 | 205,981 | 457,526 | 460,626 | 463,498 | 948,599 | 1,014,837 | 1,081,196 |
| 31 | Vushtrri | 688,234 | 708,881 | 730,147 | 119,034 | 178,551 | 238,068 | 1,228,392 | 1,236,714 | 1,244,426 | 2,035,660 | 2,124,146 | 2,212,641 |
| 32 | Zubin Potok | - | - | - | - | - | - | 30,000 | 35,000 | 40,000 | 30,000 | 35,000 | 40,000 |
| 33 | Zveçan | - | - | - | - | - | - | 35,000 | 40,000 | 45,000 | 35,000 | 40,000 | 45,000 |
| 34 | Gracanicë | 566,361 | 583,352 | 600,853 | 77,583 | 116,375 | 155,166 | 1,143,222 | 1,150,967 | 1,158,144 | 1,787,166 | 1,850,694 | 1,914,163 |
| 35 | Kllokot | 69,794 | 71,888 | 74,044 | 15,371 | 23,057 | 30,742 | 73,677 | 74,176 | 74,638 | 158,842 | 169,120 | 179,425 |
| 36 | Mitrovica veriore | | - | - | - | - | - | 60,000 | 65,000 | 70,000 | 60,000 | 65,000 | 70,000 |
| 37 | Partesh | 13,417 | 13,820 | 14,234 | 7,002 | 10,503 | 14,004 | 43,382 | 43,676 | 43,948 | 63,801 | 67,999 | 72,187 |
| 38 | Ranillug | 29,730 | 30,622 | 31,541 | 12,224 | 18,335 | 24,447 | 86,610 | 87,197 | 87,741 | 128,564 | 136,154 | 143,728 |
| TOTAL | | 27,513,434 | 28,338,837 | 29,189,002 | 5,674,222 | 8,511,333 | 11,348,444 | 49,928,922 | 50,286,080 | 50,618,500 | 83,116,577 | 87,136,249 | 91,155,945 |

## 1.11. Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2020 dhe vlersimet për vitin 2021-2022

Për ndarjen e granteve qeveritare sipas komunave për vitin 2020 janë zbatuar kriteret dhe formulat bazë të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjet e tjera relevante, si dhe bazuar në projeksionet makro-fiskale dhe të dhënave nga ministritë e linjës:

- Granti i Përgjithshëm për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 196.3 milion euro, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 15.6 milion euro si rezultat i rritjes së të hyrave të përgjithshme;
- Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 205.5 milion euro, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 20.5 milion euro;
- Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 61.7 milion euro dhe krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 8.3 milion euro;
- Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2020 është në nivel të njëjtë me vitin paraprak;
- Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 0.44 milion euro;
- Financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore historike të fshatit Zym dhe Këshillin e Hoçës së madhe në Rahovec për vitin 2020 është në shumë prej 69,048 euro;
- Granti shtesë për kryeqytetin për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 11.77 milion euro, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 0.9 milion euro;
- Financimi për Obiliqin për vitin 2020 është në shumë prej 4.2 milion euro;
- Financimi për teatro është aprovuar me kosto prej 0.9 milion euro për vitin 2020;
- Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 paraqesin një ulje prej 4 milion euro. Ulja e projeksioneve të THV vjen si rezultat i planifikimit të të hyrave nga gjykatat dhe dënimet në trafik në nivelin qendror e jo në nivelin lokal siç janë planifikuar deri me tani;
- Investimet sipas klauzolës për investime të parapara për vitin 2020 janë në shumë prej 11.5 milion euro.

Tabela 10: Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2020-2022 (mil. euro)

| Përshkrimi | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Grantet qeveritare | 392.4 | 419.1 | 463.5 | 477.8 | 493.7 |
| 1.1 Granti i përgjithshëm | 173.6 | 180.7 | 196.3 | 207.1 | 219.4 |
| Granti i përgjithshëm | 168.9 | 175.8 | | | |
| Kontigjenca për korrektim të formulës | 4.7 | 4.9 | | | |
| 1.2 Granti specifik për shëndetësi | 48.5 | 53.4 | 61.7 | 64.1 | 66.7 |
| 1.3 Granti specifik për arsim | 170.3 | 185.0 | 205.6 | 206.6 | 207.6 |
| 2. Financimi për shëndetësi sekondare | 2.6 | 2.6 | 2.6 | 2.6 | 2.6 |
| 3. Shërbimet rezidenciale | 1.7 | 1.6 | 2.0 | 2.0 | 2.0 |
| 4. Financimi për QHP, QKHFZ dhe KHM | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 |
| 5. Granti për Kryeqytetin- Prishtinën | | 10.8 | 11.8 | 12.4 | 13.2 |
| 6. Financimi për Obiliqin | | 5.0 | 4.2 | 4.2 | 4.2 |
| 7. Të hyrat vetanake komunale | 82.0 | 87.0 | 83.1 | 87.1 | 91.2 |
| 8. Financimi për teatro | | | 0.9 | 0.9 | 0.9 |
| 9. Financimi nga huamarrja | 3.7 | 4.8 | - | - | - |
| 10. Klauzola e investimeve | | 23.1 | 11.5 | | |
| **Total Financimi Komunal** | **482.41** | **554.05** | **579.74** | **587.18** | **607.84** |

Tabela në vijim paraqet burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve për nivelin Komunal.

Tabela 11: Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2020 dhe vlerësimet për 2021-2022

| Përshkrimi | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| Struktura e shpenzimeve | 482,012,850 | 554,723,208 | 579,742,718 | 587,179,253 | 607,835,845 |
| Numri i punëtorëve | 43,871 | 44,203 | 44,349 | 44,349 | 44,349 |
| Paga dhe mëditje | 256,500,000 | 272,128,520 | 308,147,000 | 325,000,000 | 339,000,000 |
| Mallra dhe shërbime | 58,530,443 | 70,993,868 | 76,993,868 | 76,993,868 | 76,993,868 |
| Shpenzime komunale | 9,688,901 | 11,233,147 | 11,233,147 | 11,233,147 | 11,233,147 |
| Subvencione dhe transfere | 8,748,307 | 12,381,347 | 12,534,346 | 12,552,238 | 12,617,191 |
| Shpenzime kapitale | 148,545,200 | 187,986,326 | 170,834,357 | 161,400,000 | 167,991,639 |
| Burimet e financimit | 482,012,850 | 554,723,208 | 579,742,718 | 587,179,253 | 607,835,845 |
| Grantet qeveritare | 396,710,572 | 439,855,843 | 485,096,141 | 500,043,004 | 516,679,900 |
| Të hyrat vetanake | 82,000,000 | 87,000,000 | 83,116,577 | 87,136,249 | 91,155,945 |
| Financimet nga huamarrjet | 3,302,278 | 4,799,011 | - | - | - |
| Financimi nga Klauzola e investimeve | | 23,068,354 | 11,530,000 | - | - |

## 1.12. Kalendari kohor për nivelin komunal

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- 30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2020-2022 nga Kuvendi Komunal,
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:
  - o Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
  - o Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2020-2022, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
  - o Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB-se dhe PIP):
  - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2020-2022 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2020 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2021-2022 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB-se, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabela 3.1.B - plani i ndarjeve buxhetore sipas klauzolës së investimeve,
  - Tabela 3.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve,
  - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor.

Departamenti i Buxhetit në MF do të organizoje forume me autoritetet komunale lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2020-2022. Gjithashtu, përmes trajnimeve shtesë do të ofrohen udhëzime me specifike rreth hartimit të buxhetit për secilën nga fazat kyçe, përfshirë aplikimin e sistemeve elektronike SZHMB dhe PIP.

## Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

**Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse**

Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Viti | Numri total i stafit | Numri total i stafit që janë gra | Numri total i stafit që janë burra | Paga dhe mëditje/Shuma për gra | Paga dhe mëditje/Shuma për burra |
|---|---|---|---|---|---|
| 2016 | | | | | |
| 2017 | | | | | |
| 2018 | | | | | |
| Planifikimi për 2019 | | | | | |

**Tabela 2. Planifikimi për vitin 2020 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore**

Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Niveli i pagave | Numri total i stafit në këtë nivel të pagave | Numri i burrave në këtë nivel | Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel | Numri i grave në këtë nivel. | Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel |
|---|---|---|---|---|---|
| 201-400 | | | | | |
| 401-600 | | | | | |
| 600+ | | | | | |

**Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)**

[Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

| Viti | Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar | Numri total i përfituesve | Numri i përfituesve gra | Numri i përfituesve burra | Buxheti për gra | Buxheti për burra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2017 | | | | | | |
| 2018 | | | | | | |
| 2019 | | | | | | |
| Planifikimi për 2020 | | | | | | |

**Aneksi 2**

INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Organizata buxhetore:.........................................................................

**Shembull:**

| **318 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve** | | |
|---|---|---|
| **Objektivi 1** | **Treguesi bazë** | **Treguesi i synuar** |
| Përmirësimi i mbikëqyrjes së aktiviteteve të minierave dhe atyre prodhuese | Numri i licencave ose numri i inspektimeve | Numri i licencave ose numri i inspektimeve |
| *Aktivitetet:* | | |
| *Rishikimi i procedurave për zvogëlimin e barrës së ndërveprimit me agjencinë* | | |
| *Grumbullimi i të dhënave (raportimi) mbi aktivitetet ekonomike për aktivitete inspektimi të synuara më mirë* | | |
| *Kryerja e hetimeve mbi aktivitetet e paligjshme* | | |
| **Objektivi 2** | **Treguesi bazë** | **Treguesi i synuar** |
| Zhvillimi i përmbledhjes së burimeve minerare | Madhësia e vlerësuar e zbulimeve | Madhësia e vlerësuar e zbulimeve |
| *Aktivitetet:* | | |
| *Mirëmbajtja e kadastrës së minierave dhe bazës së të dhënave GIS që përmbajnë të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të tjera relevante* | | |
| *Hulumtime për gjetjen e burimeve të reja minerare* | | |
| *Bashkëpunimi me universitetet dhe bizneset për të përmirësuar hulumtimin në shfrytëzimin e burimeve* | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. / Br. prot. 1819 Më / Dt. 31.05.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë të nenit 12.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 46 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2019, merr këtë:

# V E N D I M
## Për vënien në debat publik të Draft Rregullores komunale për Transparencë

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Rregullores komunale për Transparencë.

2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.

3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .

4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I  I  K O M U N Ë S  N Ë  R A H O V E C**

**01 Nr. 1819**
**Rahovec, 31.05.2019**

**Afrim Dina**
**Kryesues i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVA · Kuvendi i Komunës së Rahovecit · RAHOVEC · ORAHOVAC · Skupština Opštine · REPUBLIKA KOSOVA